

Raport

MBI VLERËN EKONOMIKE TË SEKTORIT JOFTIMPRURËS

NË BALLKANIN PERËNDIMOR & TURQI



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK



B | T | D

The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

© 2015 Balkan Civil Society Development Network

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)

Adresa: Mitropolit Teodosij Gologanov 39/II-2, 1000 Shkup, Maqedoni

E-mail: executiveoffice@balkancsd.net

Website: www.balkancsd.net | www.monitoringmatrix.net

Redaktore: Tanja Hafner Ademi

Eksperte: Dubravka Velat

Përkthimi në shqip: Aleka Pappa

Foto në ballinë: Jeff Belmonte (CC-BY)



Raport

mbi vlerën ekonomike të sektorit jofitimprurës në Ballkanin perëndimor & Turqi

Përgatitur nga

Dubravka Velat

Beograd, dhjetor 2015



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	5
Metodologjia.....	8
ANALIZA KRAHASIMORE.....	11
Gjendja e mbledhjes së të dhënave	11
Tabela krahasuese.....	13
Rekomandimet e përbashkëta.....	19
ANALIZA SIPAS VENDEVE	21
Shqipëria.....	21
Kosova.....	28
Maqedonia	32
Mali i Zi.....	39
Serbia.....	45
Turqia.....	51
Shtojcat	59

Mirënjohje

Raporti mbi vlerën ekonomike të sektorit jofitimprurës në vendet e Ballkanit perëndimor dhe Turqi është përgatitur nga Dubravka Velat me mbështetjen e Zyrës Ekzekutive të BCSDN dhe organizatave anëtare. Shumë falenderime shkojnë për anëtarët e BCSDN: Center for Development of NonGovernmental Organizations (CRNVO) nga Mali i Zi, Center for Promotion of Civil Society (CPCD) nga Bosnje-Hercegovina, Instituti per Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) nga Shqipëria, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) nga Kosova, Macedonian Center for International Cooperation (MCIC) nga Maqedonia, Civic Initiatives nga Serbia dhe Third Sector Foundation of Turkey (TUSEV) nga Turqia, për mbledhjen e të dhënave, shqyrtimin e tyre dhe orientimin e ofruar në hartimin e dokumentit dhe përpilimin e rekomandimeve. Falenderojmë veçanërisht dhe Dubravka Velat për analizmin e të dhënave dhe udhëheqjen e këtij procesi.

Hyrje

Ky raport është përgatitur si pjesë e projektit katër-vjeçar **“Acquis e Shoqërisë Civile Ballkanike - Fuqizimi i Advokacisë, Potencialit Monitorues dhe Kapaciteteve të OShC-ve”**, financuar nga BE në kuadër të “Programeve të Partneritetit për Organizatat e Shoqërisë Civile” dhe bashkë-financuar nga Balkan Trust for Democracy (BTD). Projekti po zbatohet nga Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN), në periudhën 2012-2016, në bashkëpunim me 11 partnerë nga BE, Ballkani perëndimor dhe Turqia.

Ky projekt ka dy objektiva të përgjithshëm: (1) përforcimin e bazave për monitorimin dhe advokacinë në çështjet e lidhura me mjedisin mundësues dhe qendrueshmërinë e shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe rajonal dhe (2) forcimin e strukturave për integrimin dhe pjesëmarrjen e OShC-ve në proceset e politikave dhe hapjes së negociatave për anëtarësim si në nivel evropian dhe kombëtar.

Ndër rezultatet e shumta që priten të përmbushen në këtë kuadër, veçanërisht relevant për këtë studim është Prioriteti 2: “Institucionet qeveritare njohin vlerën ekonomike të OShC-ve dhe hartojnë strategji kyç për qendrueshmërinë ekonomike dhe të burimeve njerëzore të shoqërisë civile.” Ky studim u realizua në vijim të një prej gjetjeve kryesore të raportit të parë rajonal të Matricës së Monitorimit për 2013: “Duhet të ketë një sistem të mirë-organizuar që mbledh statistika mbi OShC-të dhe siguron që të dhënat janë të disponueshme për publikun, si dhe përdoren në zhvillimin e politikave mbështetëse për rritjen e sektorit”. Ky konstatim vihet në dukje edhe në “Udhëzimet mbi mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit për periudhën 2014-2020.”

Për përmbushjen e këtij prioriteti, studimi mbi vlerën ekonomike të sektorit jofitimprurës në Ballkanin perëndimor dhe Turqi filloi në shtator 2014 me hartimin e pyetësorit të parë mbi mbledhjen e të dhënave. Në tetor 2014, nisi procesi i identifikimit të të dhënave fillestare, ndjekur nga një workshop rajonal i zhvilluar në Beograd, Serbi, me partnerët e projektit në datat 3 dhe 4 nëntor 2014. Workshop-i kishte për qëllim hartimin e një plani për mbledhjen e të dhënave në vendet kontribuese në studim. Kjo punë përgatitore solli mbledhjen e të dhënave për shtatë vende. Analizimi dhe interpretimi i tyre u zhvillua përgjatë periudhës qershor-nëntor 2015.

Qëllimi i këtij studimi është të mundësojë një disponueshmëri më të madhe të statistikave rreth tipareve financiare dhe të burimeve njerëzore të shoqërisë civile. Ai synon të sfidojë mitet mbi parametrat financiarë dhe madhësinë e sektorit (i.e. buxhetet vjetore, niveli i pagave, numri i të punësuarve) dhe të ofrojë një vështrim më të thelluar mbi sektorin dhe ndikimin e tij në zhvillimin dhe zbatimin e politikave në vendet në shqyrtim. Studimi reflekton dhe mbi rëndësinë e sektorit për shoqërinë dhe rritjen e ndërgjegjësimit midis aktorëve shtetërorë për nevojën e mbështetjes së shoqërisë civile përmes buxheteve vjetore dhe burimeve të tjera. Në fund, pritet që institucionet qeveritare të njohin vlerën ekonomike të OShC-ve dhe të hartojnë strategji kyç për qendrueshmërinë ekonomike dhe të burimeve njerëzore të shoqërisë civile.

Për herë të parë, ky studim jep një vështrim të përgjithshëm të situatës aktuale të sektorit jofitimprurës në lidhje me mbledhjen e të dhënave, analizimin dhe prezantimin e tyre në shtatë vendet e përfshira në studim: Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë dhe Turqinë. Studimi jep informacion mbi cilësinë dhe besueshmërinë e statistikave rreth impaktit ekonomik të sektorit në këto vende, duke përfshirë dhe sfidat që OShC-të përballen për të siguruar këto të dhëna. Për më tepër, ky hulumtim i thelluar hartëzon dhe ravijëzon kapacitetet financiare dhe madhësinë dhe vlerën e sektorit vis-à-vis ekonomisë në tërësi. Ai synon të kontribuojë në procesin e 'ligjshmërit' të sektorit jofitimprurës dhe aktiviteteve të tij përgjatë rajonit duke përshkruar pozicionin e sektorit në tregun e punës dhe rritjen ekonomike, pozicioni i cili, jo rrallëherë, injorohet.

Në këtë studim, termi “sektor jofitimprurës” i referohet strukturave jo-shtetërore, vullnetare, ku individët organizohen në ndjekje të objektivave dhe idealeve të përbashkëta dhe që janë zyrtarisht të regjistruara si shoqata ose fundacione, sipas ligjeve respektive në fuqi.¹ Në varësi të vendit, përkufizimi ligjor mund të përfshijë dhe shoqatat e sporteve, fesë, gjetisë, shoqatat profesionale ose ato të hobeve të tjera. Në raport, termat “jofitimprurës”, “sektor jofitimprurës”, “shoqëri civile” dhe “sektor i shoqërisë civile” përdoren në vend të njëra-tjetrës.

Ky studim ndahet në dy kapituj kryesorë: analiza krahasimore dhe analiza sipas vendeve. Kapitulli i analizës krahasimore ofron një panoramë të përgjithshme të sfidave të përbashkëta në mbledhjen e të dhënave për të shtatë vendet, parametrat kyç

¹ Përshtatur nga “Udhëzimet mbi mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile në vendet e zgjerimit për periudhën 2014-2020.”
http://www.civilnodrustvo.gov.rs/upload/old_site/2012/10/ELARG-Guidelines-CS-support-Final-14102013.pdf

ekonomikë të paraqitur përmes grafikëve, si dhe rekomandimet e përbashkëta për të gjithë rajonin.

Kapitulli me analizat sipas vendeve jep një përshkrim më të detajuar të situatës së mbledhjes së të dhënave së bashku me sfidat dhe pengesat, si dhe paraqet të dhëna ekonomike më të detajuara. Rekomandimet specifike synojnë të ndihmojnë në zhvillimin e fushatave të advokacisë për të mundësuar disponueshmërinë dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë sistematike dhe të standardizuar.

Metodologjia

Përdorimi i një metodologjie të standardizuar u dakordësua qysh në fazën e parë të zbatimit të projektit. U krye shqyrtimi i literaturës për të hetuar mbi metodologjitë e përdorura më parë në paraqitjen e “anës ekonomike” të sektorit.

Pika fillestare ishte “Manuali i OKB-së mbi Institucionet jofitimprurëse në Sistemin e Llogarive Kombëtare,² hartuar nga Qendra Johns Hopkins për Studimet e Shoqërisë Civile në bashkëpunim me Drejtorinë e Statistikave të OKB-së dhe një grupi ndërkombëtar ekspertësh, publikuar nga OKB në 2003. Për herë të parë, manuali u rekomandon zyrtare kombëtare statistikore të gjenerojnë rregullisht “llogari satelitore” për institucionet jofitimprurëse dhe vullnetarizmin. Në mars 2013, ekipi i autorëve nën udhëheqjen e Lester M. Salamon të Universitetit John Hopkins (Qendra për Studimet e Shoqërisë Civile)³ botoi “Situata e shoqërisë civile botërore dhe vullnetarizmi – Gjetjet e fundit nga zbatimi i manualit të OKB-së për jofitimprurësit”, që përbën një tjetër burim të vlefshëm informacioni në këtë drejtim.

Përveç kësaj, për të marrë informacione mbi të dhënat kyçe u shqyrtuan botime të tjera të ngjashme mbi vlerën ekonomike të sektorit në vendet e BE-së (për shembull, publikime nga Italia,⁴ Britania e Madhe⁵ dhe Manuali i ILO-s mbi matjen e punës vullnetare.⁶

² United Nations Statistics Division, Handbook on Non-Profit Institutions in the System of National Accounts. Series F, No. 91,. St/ESA/Stat/Ser.F/91. (New York: United Nations, 2003). [UN NPI Handbook, 2003]. Vendet e përfshira në raport janë: Australia, Belgjika, Brazili, Kanadaja, Republika Çeke, Franca, Izraeli, Japonia, Kirgistani, Meksika, Zelanda e Re, Norvegjia, Portugalia, Tailanda dhe SH.B.A. SH.B.A nuk ka gjeneruar ende një “llogari satelitore” të plotë, por ka prodhuar një seri tabelash me të dhëna të krahasueshme me ato të një llogarie satelitore për sektorin jofitimprurës.

³ http://ccss.jhu.edu/wp-content/uploads/downloads/2013/04/JHU_Global-Civil-Society-Volunteering_FINAL_3.2013.pdf; autorë: Lester M. Salamon, S. Wojciech Sokolowski, Megan A. Haddock, Helen S. Tice.

⁴ http://ec.europa.eu/citizenship/pdf/national_report_it_en.pdf

⁵ <http://data.ncvo.org.uk/a/almanac15/economic-value/>

⁶ http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---stat/documents/publication/wcms_162119.pdf

Përpjekjet ndërkombëtare për matjen e vlerës ekonomike të shoqërisë civile

Të dhënat në dispozicion si dhe natyra financiare e sektorit jofitimprurës e bëjnë të vështirë matjen e vlerës së sektorit në raport me ekonominë në tërësi. Aktualisht, nga nismat dhe risitë në këtë fushë mund të përmendim:

- Manualin e OKB-së për Llogaritë Satelitore i përditësuar, që do të publikohet në 2016.
- GuideStar (<http://www.guidestar.org/Home.aspx>) është burimi më i madh në botë i të dhënave mbi organizatat jofitimprurëse. GuideStar është një paketë software ndërkombëtare që mbledh dhe vë në dispozicion të dhëna për organizatat jofitimprurëse që përfshijnë: misionin, ndikimin, reputacionin, financat, programet, transparencën, qeverisjen etj. Çdo organizatë mund të regjistrohet dhe të ngarkojë raportet e saj online.
- Impakti i sektorit të tretë (<http://thirdsectorimpact.eu/>) është një projekt kërkimor që synon të kuptojë shtrirjen dhe shkallën e sektorit të tretë në Evropë, ndikimin e tij aktual dhe potencial, si dhe barrierat që e pengojnë sektorin për të kontribuar plotësisht në mirëqenien e kontinentit. Një nga fushat e veprimtarisë të këtij projekti është matja (ose kuantifikimi). Vetëm pak vende gjenerojnë në mënyrë sistematike të dhëna që rrokin pjesë të konsiderueshme të sektorit të tretë, dhe po këto vende ndërkaq, përdorin përkufizimet ligjore kombëtare që e bëjnë analizën krahasuese të vështirë. TSI do të propozojë mjete të caktuara statistikore për të matur sektorin e tretë në Evropë, duke u nisur nga supozimet e mëposhtme metodologjike: matjet e shkallës duhet të kenë parasysh karakteristikat e veçanta të sektorit të tretë dhe faktin se pjesa më e madhe e aktiviteteve nuk ndërmerren për arsye fitimprurëse; dhe, masat financiare nuk shterojnë karakteristikat e sektorit. Për më tepër, duke pasur parasysh karakterin fluid të sektorit dhe kufizimet ekzistuese në burimet e të dhënave, masat për kuantifikimin sasior mund të përfshijnë edhe numrin e subjekteve dhe burimet njerëzore që këto organizata angazhojnë.

Një listë fillestare e të dhënave të mundshme u hartua dhe diskutua midis partnerëve (shih Shtojcën 1) gjatë workshop-it të Beogradit në 3 dhe 4 dhjetor 2014. Përmes një procesi konsultativ, u dakordësua në zvogëlimin e numrit të të dhënave që do të përpunoheshin, pasi procesi i mëparshëm shfaqti një mungesë të konsiderueshme të statistikave në pothuaj të gjitha vendet. Si rrjedhojë, u hartua një pyetësor me shtatë të dhëna kyçe që përfshinin: të ardhurat e përgjithshme, strukturën e të ardhurave, shpenzimet e përgjithshme, strukturën e shpenzimeve, shpenzimet për tatime (TVSH + tatimi mbi të ardhurat personale + tatimi mbi fitimin), numrin e të punësuarve dhe numrin e vullnetarëve (shih Shtojcën 2). Duke pasur parasysh nivelin e

disponueshmërisë së të dhënave, u dakordësua se ky ishte numri optimal i të dhënave fillestare.

Partnerët e përfshirë në këtë studim, anëtarë të BCSDN, janë si më poshtë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Shqipëri), Center for the Promotion of Civil Society (Bosnje-Hercegovinë), Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (Kosovë), Macedonian Center for International Cooperation (Maqedoni), Center for Development of Non Governmental Organizations (Mali i Zi), Civic Initiatives (Serbi) dhe TUSEV (Turqi).

Metodologjia e përdorur kombinoi kontaktet/lidhjet e drejtpërdrejta të partnerëve me institucionet shtetërore që gjenerojnë statistikën, me shqyrtimin e të dhënave statistikore dhe financiare ekzistuese (p.sh. nga ministritë e financave/administratat tatimore, regjistrat kombëtare, zyrat statistikore, fondet pensionale etj). Të dhënat e përdorura përfshinë dhe të dhëna të përgjithshme të popullsisë (censuset, projeksionet e popullsisë) dhe të dhëna të përgjithshme ekonomike (punësimi i përgjithshëm, PBB).

Kjo metodologji u mundësoi partnerëve të përfshirë në studim të vlerësojnë se cilat statistika mbledhen dhe janë të disponueshme, duke krijuar kështu bazën për advokimin në drejtim të përmirësimit të mbledhjes dhe disponueshmërisë së të dhënave në vitet e ardhshme.

ANALIZA KRAHASIMORE

Gjendja e mbledhjes së të dhënave

O ShC-të nuk konsiderohen si një forcë ekonomike me rëndësi dhe në rritje prandaj, në pjesën më të madhe të vendeve, ka një numër të kufizuar ose ka dhe mangësi të të dhënave statistikore. Nëse këto të dhëna ekzistojnë, ato zakonisht nuk mblidhen nga organi zyrtar statistikor, por nga institucione të tjera, siç mund të jenë regjistrat kombëtarë, administrata tatimore, ministri të ndryshme, fondet pensionale ose organe të tjera.

Ka dallime të mëdha midis vendeve në mënyrën se si paraqiten strukturat e të ardhurave dhe shpenzimeve, prandaj krahasimi rajonal është bërë vetëm në bazë të shifrave të përgjithshme (në bazë të totalit). Ndërkohë, edhe nëse statistikat ekzistojnë ato nuk janë të përpunuara në mënyrë të atillë që tipari dallues i sektorit jofitimprurës të jetë i dukshëm. OShC-të nuk diferencohen nga sektorët e tjerë të ekonomisë (për shembull, për statistikat mbi punësimin ose pagat). "Raporti vjetor për performancën financiare të institucioneve jofitimprurëse në Serbi" që publikohet nga Agjencia Serbe e Regjistrimit të Bizneseve (SBRA) mund të shërbejë si pikënisja e një praktike të mirë për vendet e tjera, edhe pse ky raport kërkon disa përmirësime në nivelin e detajeve që ofron.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave statistikore, partnerët e BCSDN janë përballur me sfida të ndryshme që varionin nga heshtja e administratës, refuzimi i dhënies së informacionit në bazë të ligjit për të drejtën e informimit në fuqi dhe deri tek kërkesa për dhënien e informacionit kundrejt pagesës. Në disa vende ka qenë veçanërisht i vështirë bashkëpunimi me administratën tatimore. Ndërkohë, në disa raste të veçanta, as institucionet e tjera dhe as partnerët tanë nuk ishin në dijeni të disponueshmërisë së statistikave. Për shembull, përkundrejt vlerësimeve fillestare, në disa vende fondet pensionale ishin një burim shumë i rëndësishëm informacioni për të dhënat mbi punësimin.

Në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi rëndësia e mbledhjes së statistikave të rregullta për OShC-të njihet në dokumente të ndryshme strategjike, por nuk përmendet në dokumentet revelante të vendeve të tjera. Mali i Zi dhe Maqedonia janë dy vendet e

vetme që kanë caktuar një përfaqësues të OShC-ve në këshillat e tyre statistikore, por kjo mundësi nuk shfrytëzohet ende në potencialin e saj të plotë.

Nuk ka të dhëna mbi shpenzimet për tatime (TVSH + tatimi mbi të ardhurat personale + tatimi mbi fitimin) në pjesën më të madhe të vendeve.

Me përjashtim të Turqisë, asnjë vend tjetër nuk gjeneron statistika mbi numrin e vullnetarëve. Ndërkohë, edhe për Turqinë shifrat mbeten të diskutueshme dhe nevojitet një nivel i lartë diskrecioni në raportimin e tyre, pasi nuk ka një përkufizim ligjor të vullnetarëve. Si rrjedhojë, mungon informacioni mbi vlerën e vullnetarizmit, i cili nëse matet mund të përfaqësojë një kontribut të rëndësishëm në vlerën ekonomike të sektorit.

Në raport vihen re praktika të ndryshme të mbledhjes dhe disponueshmërisë së statistikave për OShC-të, të cilat mund të shërbejnë si një pikë e shkëlqyer fillimi në ndihmë të OShC-ve të rajonit për të përmirësuar situatën në vendet e tyre.

Tabela në vijim paraqet një pasqyrë të të dhënave kyçe për shtatë vendet, ndjekur nga një prezantim grafik i të dhënave krahasuese. Për të vendosur statistikat e OShC-ve në perspektivë, tabela është pasuruar me të dhëna mbi popullsinë, numrin e përgjithshëm të OShC-ve, PBB-në dhe punësimin e përgjithshëm.


Të gjitha të dhënat financiare janë në euro. Vlen të theksohet se ato mbulojnë periudhën 2013-2015, duke qenë se mbledhja dhe disponueshmëria e statistikave ndryshon në varësi të vendit. Pavarësisht kësaj, të dhënat janë të natyrës përshkruese dhe besojmë se ofrojnë informacion të mjaftueshëm për qëllime krahasuese. Për më tepër, këto të dhëna përfaqësojnë një pikënisje të mirë për të vëzhguar trendet në fushën e vlerës ekonomike të sektorit të tretë.

Tabela krahasuese

	Shqipëria (2014)	Bosnje- Hercegovinë (2014)	Kosovë (2014)	Maqedoni (2014)	Mali i Zi (2014)	Serbi (2013)	Turqi (2013)
Popullsia	2,800,138	3,791,622	1,844,553	2,069,172	620,029	7,186,862	76,667,865
Numri i OShC-ve	2,427	12,000	8,014	4,156	3,300	23,394	102,727
Numri i qytetarëve për OShC	1154	316	230	498	188	307	746
Të dhëna mbi performancën ekonomike							
PBB	10,059,000,000	13,667,000,000	5,326,700,000	8,535,000,000	3,425,000,000	34,263,000,000	616,345,000,000
% e të ardhurave të përgjithshme të OshC- ve në raport me PBB	0.25%	N/A	N/A	0.96%	0.58%	0.74%	1.34%
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	25,372,256	N/A	N/A	81,516,756	19,889,292	254,713,543	8,282,157,668
Të ardhurat mesatare për OShC	10,454	N/A	N/A	19,614	6,027	10,888	806,23
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve	24,826,390	N/A	N/A	60,226,397	N/A	247,615,305	4,916,022,161
Shpenzimet për tatime (TVSH+tatimet mbi të ardhurat personale+ tatimi mbi fitimin)	3,033,325	N/A	N/A	N/A	2412946	N/A	N/A
Numri i të punësuarve në OshC	7,505	N/A	8,743	1,897	776	6,729	50,976
Numri i përgjithshëm i të punësuarve	1,048,908	N/A	338,400	501,788	210,900	1,715,164	259,330,008,743
% e të punësuarve në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm	0.72%	N/A	2.58%	0.38%	0.37%	0.39%	0.20%
Numri i të punësuarve për OShC	3.09	N/A	1.09	0.46	0.24	0.29	0.5
Numri i vullnetarëve	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	1,183,435


Shënim: Informacionet mbi burimet e të dhënave dhe shpjegimet përkatëse jepen në tabelat specifike sipas vendeve.

Numri i OShC-ve



Duke pasur parasysh madhësinë e vendeve në shqyrtim, ishte e pritshme që Turqia do të kishte numrin më të madh të OShC-ve. Shqipëria ka numrin më të vogël të OShC-ve, ndërsa Kosova dhe Mali i Zi kanë një numër relativisht të lartë të OShC-ve për frymë.

Numri i qytetarëve për OShC




Të dhënat mbi numrin e qytetarëve për OShC mund të jenë ilustruese të aktivizmit qytetar. Për shembull, një numër më i vogël qytetarësh për OShC mund të pasqyrojë një nivel aktivizmi më të lartë, por edhe mund të vijë si rrjedhojë e 'inflacionimit' në numrin e OShC-ve, të cilat mund të mos jenë domosdoshmërisht të gjitha aktive. Shqipëria ka numrin më të madh të qytetarëve për OShC (1154), ndërsa Mali i Zi numrin më të vogël (188). Këto të dhëna mund të krahasohen me të dhënat e paraqitura në "Raportin e Shoqërisë Civile Ndërkombëtare",⁷ përgatitur nga Departamenti Turk i Shoqatave, Ministria e Punëve të Brendshme, në korrik të 2013. Sipas raportit, numri mesatar i qytetarëve për OShC varionte nga 95 në Kroaci, 138 në

⁷ http://www.tacso.org/doc/nar_tr2014april.pdf

Gjermani, 143 në Hungari, 198 në SHBA, 203 në Kanada dhe 344 në Britaninë e Madhe.


Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB-në, në %



Raporti i të ardhurave të përgjithshme të OShC-ve me PBB-në kombëtare mund të llogaritet vetëm për pesë vende. Bosnje-Hercegovina dhe Kosova ose nuk kishin të dhëna të besueshme mbi të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve ose u mungonin të dhënat. Turqia ka përqindjen më të lartë të të ardhurave të përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB-në kombëtare (1.34%), ndjekur nga Maqedonia (0.96%), Serbia (0.74%) dhe Mali i Zi (0.58%). Shqipëria ka përqindjen më të ulët (0.25%). Megjithatë, të dhënat e mësipërme nuk përfshijnë vlerën e kontributit vullnetar. Nëse kjo llogaritje do të ishte e mundur nga ana metodologjike, përqindja do të ishte më e lartë. Për shembull, përqindja mesatare e sektorit jofitimprurës⁸ ndaj PBB-së në 16 vendet e mbuluara nga studimi i sipërcituar i John Hopkins është 4.5%, nga ku 3.6% është përqindja pa përfshirë kontributin vullnetar dhe 0.9% është kontributi i vullnetarëve.


⁸ NPI - Non-Profit Institutions.

Të ardhurat mesatare për OShC, në euro



Turqia ka të ardhurat mesatare më të larta për OShC (80,623 euro) ndërsa Mali i Zi shënon të ardhurat më të ulta (6,027 euro). Të dhënat për Bosnje-Hercegovinën dhe Kosovën nuk janë të disponueshme. Megjithatë, këto të dhëna nuk reflektojnë dallimet e mëdha në shpërndarjen e të ardhurave midis OShC-ve brenda vendeve, veçanërisht dallimet që ekzistojnë mes shoqatave dhe fondacioneve në Serbi dhe Turqi.

Numri i të punësuarve në OShC




Të dhënat mbi numrin e të punësuarve i referohen të ashtu-quajturit "punësim të plotë" i.e. personeli i OShC-ve i regjistruar zyrtarisht dhe me kontribute të plota të mbuluara. Ndërkohë, pjesa më e madhe OShC-ve, në fakt, angazhojnë staf me lloje të ndryshme kontratash, të cilat nuk gjejnë pasqyrim në këtë grafik. Kjo do të thotë se numri aktual i individëve të angazhuar në sektorin jofitimprurës është më i lartë se ai i paraqitur. Megjithatë, jo të gjitha vendet mbledhin statistika për llojet e tjera të punësimit.

Siç pritej, Turqia ka numrin më të madh të punësuarve në sektorin jofitimprurës. Kjo vjen si rrjedhojë e faktit që numri i OShC-ve të regjistruara në Tuqi është më shumë se


dy herë më i madh se numri i OShC-ve të të gjitha vendeve të tjera të bëra bashkë. Për Bosnje-Hercegovinën nuk ka të dhëna të disponueshme.

Numri mesatar i të punësuarve për OShC



Shqipëria ka numrin më të madh mesatar të punësuarve për OShC (3.09), ndjekur nga Kosova (1.09). Vendet e tjera kanë një numër dukshëm më të vogël mesatar të të punësuarve për OShC: Turqia (0.50), Maqedonia (0.46), Serbia (0.29) dhe Mali i Zi (0.24). Për Bosnje-Hercegovinën nuk ka të dhëna të disponueshme.

% e të punësuarve në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm në vend



Kosova ka përqindjen më të lartë të punësuarve në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (2.58%), shifër kjo dallueshmërisht e lartë nëse krahasohet dhe me vendet e tjera në shqyrtim. Për shembull, edhe pse nuk është e përfshirë në këtë raport, në Republikën Çeke raporti është 1.9%. Kosovën e ndjek Shqipëria me 0.72%, ndërsa Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi variojnë midis intervalit 0.37% dhe 0.39%.

Turqia ka pjesëmarrjen më të ulët (0.20%), ndërsa për Bosnje-Hercegovinën nuk ka të dhëna të disponueshme.

Studimi i Johns Hopkins tregon se për 13 vendet e mbuluara përqindja mesatare e fuqisë punëtore të institucioneve jofitimprurëse në raport me fuqinë punëtore të përgjithshme është 7.4% (5.2% fuqi punëtore e paguar dhe 2.2% vullnetarë).

Rekomandimet e përbashkëta

Duke u bazuar në vlerësimin e situatës së mbledhjes së të dhënave dhe disponueshmërisë së tyre, rekomandimet e përbashkëta duhet të jenë përbërësi kryesor i një qasjeje të unifikuar në strategjitë e ardhshme të advokimit. Rekomandimet janë përpiluar në mënyrë të atillë që të ndihmojnë qeveritë në ndërmarrjen e masave të nevojshme në këtë drejtim dhe të ndihmojnë OShC-të të advokojnë për këto masa.

- **Njohja dhe identifikimi i sektorit jofitimprurës si një sektor me karakteristika të dallueshme duke përdorur një klasifikim/kategorizim specifik.** Në këtë kontekst, është i nevojshëm hartimi i statistikave të veçanta të përshtatura ndaj specifikave të sektorit jofitimprurës, ndërsa shmanget mbingarkesa dhe zbatohet parimi i proporcionalitetit. Ky proces mund të lehtësohet duke përdorur Llogaritë Satelitore të OKB-së për institucionet jofitimprurëse (NPI), të cilat ofrojnë një set standard udhëzimesh për evidentimin e llogarive të sektorit jofitimprurës në llogaritë kombëtare bazuar në metodologjinë e Sistemit Ndërkombëtar të Llogarive Kombëtare (SNA).
- **Mundësimi i krahasueshmërisë me sektorët e biznesit dhe sektorët jofitimprurës rajonalë/ndërkombëtarë.** Zhvillimi i një qasjeje për mbledhjen e statistikave mbi sektorin jofitimprurës kërkon një rishikim të politikave për llogaritë dhe formatet e raportimit të OShC-ve, sidomos duke pasur parasysh strukturat e raportimit për të ardhurat dhe shpenzimet, për të mundësuar kështu krahasimin me sektorët e biznesit dhe sektorët jofitimprurës rajonalë/ndërkombëtarë.
- **Advokimi për botimin e rregullt të statistikave bazë të sektorit jofitimprurës nga ana e institucioneve përkatëse.** Statistikat bazë përfshijnë të dhënat ekonomike të sektorit që mbledhen nga organet përkatëse, siç janë autoritetet tatimore, regjistrat publikë, institucionet statistikore, fondet pensionale etj. Statistika të dobishme do të ishin të ardhurat e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, shpenzimet e përgjithshme dhe struktura e tyre të detajuar, dhe të dhëna të disagreguara për punësimin, duke përfshirë numrin e të punësuarve sipas llojit të kontratës ose pagat mesatare.
- **Ofrimi i statistikave përmbledhëse pa pagesë.** Grumbullimi i të dhënave në një dokument unik përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në paraqitjen e të dhënave ekonomike për sektorin. Idealja do të ishte që statistikave të botoheshin në formën e një dokumenti publik të disponueshëm në faqet e internetit të institucioneve.

- **Pasqyrimi i rëndësisë dhe nevojës për mbledhjen sistematike të statistikave, për botimin dhe analizën e tyre, në dokumentet strategjike në lidhje me OShC-të** (strategji, marrëveshje, etj.). Kjo duhet të zbatohet dhe për dokumentet ekzistuese të cilat mund të kenë nevojë për rishikim dhe për çdo dokument tjetër në të ardhmen.
- **Monitorimi i zhvillimit të shoqërisë civile sipas udhëzimeve të BE-së për mbështetjen e shoqërisë civile në vendet e zgjerimit, 2014-2020, siç kërkohet dhe nga Komisioni Evropian për qeveritë e vendeve të zgjerimit.** Tërësia e objektivave, rezultateve dhe indikatorëve për mbështetjen e BE-së për shoqërinë civile bën të mundur matjen e progresit si në nivel vendi ashtu edhe në rajonin e zgjerimit.
- **Mbledhja sistematike e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe hartimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB.** Vullnetarizmi përfaqëson një tipar thelbësor dhe të dallueshëm të shoqërisë civile. Vullnetarët kontribuojnë në ekonomi dhe në PBB, kështu që paraqitet me rëndësi matja e vlerës që vullnetarizmi sjell në shoqëri. Si një pikënisje e mirë për të hartuar një metodologji vlerësimi mund të shërbejë "Manuali i ILO-s mbi matjen e punës vullnetare".
- **Shfrytëzimi i mëtejshëm i mekanizmave ekzistues të bashkëpunimit midis qeverisë dhe OShC-ve për të advokuar për mbledhjen sistematike të të dhënave, analizën dhe botimin e tyre, dhe/ose advokimin për ngritjen e këtyre mekanizmave nëse ato nuk ekzistojnë** (për shembull, një person kontakti për OShC-të, Këshilli i Statistikave etj.).
- **Zbatimi në praktikë i së drejtës për informim, përgjegjshmërisë dhe afateve për marrjen e informacionit nga institucionet shtetërore në përputhje me legjislacionin ekzistues për të drejtën e informimit.**

Në kapitullin në vijim jepen rekomandimet specifike sipas vendeve, pas prezantimit të gjendjes aktuale dhe statistikave për çdo vend. Rekomandimet duhet të përdoren si një pikënisje për partnerët për të zhvilluar strategji dhe veprime advokimi më të hollësishme, me audienca dhe mesazhe të veçanta.

ANALIZA SIPAS VENDEVE

Shqipëria

Gjendja e mbledhjes së statistikave

Të dhënat ekonomike/financiare rreth sektorit jofitimprurës në Shqipëri nuk janë të disponueshme për publikun. Këto të dhëna mund të sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit në varësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, megjithatë është e nevojshme të dërgohet një kërkesë për informim në përputhje me nenet e Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Partneri zbatues i projektit në Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i siguroi të dhënat e agreguara përmes kërkesave për informim drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe përmes të dhënave dytësore nga “Udhërrëfyesi për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile”.

“Udhërrëfyesi për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile”⁹ u miratua në 27 maj 2015, me VKM nr.459. Në “Udhërrëfyes”, mbledhja dhe disponueshmëria e të dhënave për zhvillimin e shoqërisë civile konsiderohet si fusha e shtatë prioritare e veprimit. Veprimet e propozuara për këtë fushë janë si më poshtë vijon:

- 7.1 ndryshimi i ligjit aktual për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse në mënyrë që të lejojë krijimin e regjistrit elektronik;
- 7.2 krijimi i një databaze të aksesueshme publike që do të përditësohet rregullisht me të gjithë informacionin relevant për OShC-të;
- 7.3 ndryshimi i legjislacionit aktual ose hartimi i legjislacionit të ri që rregullon raportimin financiar të OJF-ve, me qëllim që të përgatiten modele të reja

⁹ <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/udherrefyesi-i-shoqerise-civile&page=1>

raportimi që mundësojnë përgatitjen e statistikave më të avancuara për OShC-të;

7.4 publikimi i skedave të përditësuara me statistika kyçe për kontributin e sektorit të shoqërisë civile në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit, si dhe përhapja e gjerë e rezultateve.

INSTAT ka nënshkruar një marrëveshje binjakëzimi¹⁰ me Zyrën Qendrore të Statistikave të Irlandës (CSO). Ky binjakëzim mund të shfrytëzohet për të rritur presionin mbi INSTAT-it për të mësuar rreth praktikave më të mira për përfshirjen e të dhënave statistikore mbi organizatat jofitimprurëse.

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Shqipëri

Popullsia (censusi i fundit, 2011) ¹¹	2,800,138
Numri i OShC-ve në 2014 ¹²	2,427
Numri i qytetarëve për OShC	1,154
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Shqipëri (2014)
PBB ¹³	10,059,000,000
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	0.25%
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve ¹⁴	25,372,256
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve ¹⁵	24,826,390
Shpenzimet për tatime (TVSH+tatimi mbi të ardhurat personale+tatimi mbi fitimin) ¹⁶	3,033,325
Numri i të punësuarve në OShC ¹⁷	7,505
Numri i përgjithshëm i të punësuarve ¹⁸	1,037,061
Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%)	0.72%
Numri i të punësuarve për OShC	3.09
Numri i vullnetarëve	N/A
	1 EUR = 138.99 ALL ¹⁹

¹⁰ http://www.instat.gov.al/media/305886/press_release.pdf

¹¹ http://www.instat.gov.al/media/178091/tab_1_1_1.xls

¹² Në 2014, numri i OShC-ve aktive ose OShC-ve të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ishte 2427 (siç citohet në 'Udhërrëfyesin për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile'), ndërsa numri i OShC-ve të regjistruara në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë sipas Ligjit 8789 'Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse' është 8449 (siç citohet në Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri 2014).

¹³ <http://countryeconomy.com/countries/albania>

¹⁴ E dhënë e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përmes kërkesës për informim.

¹⁵ E dhënë e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përmes kërkesës për informim.

¹⁶ E dhënë e marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përmes kërkesës për informim.

¹⁷ Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për 2014 (siç citohet në 'Udhërrëfyesin për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile')

¹⁸ http://www.instat.gov.al/media/291851/tregu_punes_2014_-----.pdf

¹⁹ <http://www.exchange-rates.org/Rate/EUR/ALL/11-6-2014>

Të dhënat për vitin 2014 tregojnë se në Shqipëri operojnë 2427 OShC të regjistruara me organet tatimore dhe të cilat angazhojnë 7505 të punësuar.²⁰

Përqindja e të ardhurave të përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB-në kombëtare është 0.25%, ose përqindja më e ulët midis vendeve të mbuluara nga ky studim. Të ardhurat mesatare për një OShC janë 10,454 euro, një shifër kjo e ngjashme me OShC-të në Serbi. Ndërkohë, shpenzimet për tatime zënë 12.2% të shpenzimeve të përgjithshme. Mungojnë të dhëna të detajuara mbi strukturën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të punësuarit në OShC përfaqësojnë 0.72% të punësimit të përgjithshëm në Shqipëri. Numri mesatar i të punësuarve për OShC është 3.09, e cila është dhe mesatarja më e lartë në krahasim me vendet e tjera.

Rekomandime për Shqipërinë

- Zbatimi i “Udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile”, veçanërisht i prioriteteve në fushën e shtatë të veprimit (shih pikat 7.1, 7.2, 7.3 dhe 7.4 më sipër);
- Ofrimi i të dhënave pa pagesë, në një dokument publik të aksesueshëm në faqet e internetit të institucioneve përkatëse;
- Mbledhja në mënyrë sistematike e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe zhvillimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB;
- Zbatimi në mënyrë adekuate i ligjit “Për të drejtën e informimit”;
- Shfrytëzimi nga INSTATI i përvojave dhe praktikave të mira të Zyrës Qendrore të Statistikave të Irlandës, në kuadër të marrëveshjes së binjakëzimit mes tyre.

²⁰ Udhërrëfyesi për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile’.

Bosnje-Hercegovina

Gjendja e mbledhjes së statistikave

Në Bosnje-Hercegovinë, të dhënat mbi OShC-të dhe performancën e tyre ekonomike/financiare mund të sigurohen vetëm përkundrejt pagesës që ka një kosto të lartë. Partneri zbatues i projektit në Bosnje-Hercegovinë, Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), ka kërkuar të dhënat pa pagesë nga Ministria Federale e Financave, por ky informacion i kërkuar është refuzuar – në kundërshtim me përcaktimet në rregulloren e brendshme të ministrisë. Ministria e interpreton mundësinë e dhënies së informacionit pa pagesë të vlefshme vetëm për institucionet shtetërore. Ndërkohë, organizimi i ndërlikuar institucional i Bosnje-Hercegovinës e vështirëson më tepër mbledhjen e të dhënave.

Agjencia për shërbimet financiare, informative dhe ndërmjetëse (AFIP²¹), e themeluar nga Qeveria e Republikës Srpska si një organ i pavarur dhe jofitimprurës, është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave financiare të subjekteve të ndryshme ligjore. Agjencia tarifon për shërbimet e saj, megjithatë, ligji për AFIP parashikon se të dhënat e nevojshme për punën e organeve të administratës publike ofrohen pa pagesë për këto organe.

CPCD ka kontaktuar me Departamentin për Asistencë Ligjore për Shoqatat në varësi të Ministrisë së Drejtësisë për të siguruar të dhënat nga Ministria e Financave dhe për t'i vënë në dijeni të kësaj sfide në procesin e mbledhjes së këtyre të dhënave. CPCD mbeteshin ende në pritje të një përgjigje në kohën kur po shkruhej ky raport.

Situata e pagesës për të dhënat përshkruhet në shembullin që vijon. AFIP ka të dhëna për rreth 7500 subjekte juridike të konsideruara si OShC në Bosnje-Hercegovinë. Megjithatë, jo të gjitha OShC-të dorëzojnë raporte financiare dhe si rrjedhojë, mungon një pjesë e të dhënave financiare. Për ato OShC që i kanë dorëzuar raportet e tyre financiare, Agjencia kërkon 1 euro për raport – shumë që mund të arrijë deri në 7500 euro për të gjitha OShC-të. Ndërkohë, dhe numri i përgjithshëm i OShC-ve që kanë dorëzuar raportet e tyre financiare nuk është i disponueshëm paraprakisht, duke e pamundësuar njohjen e shumës financiare që duhet paguar.

Në Republikën Srpska, vlerësohet se rreth 2160 raporte financiare të disponueshme mund të blihen për 825 euro, shumë që mund të arrijë deri në 8325 euro nëse përfshihen dhe të dhënat në nivel kombëtar.

²¹ <http://www.afip.ba/>

Vlen të theksohet se Agjencia e Statistikave të Bosnje-Herzegovinës ka miratuar "Strategjinë për zhvillimin e statistikave në Bosnje-Herzegovinë 2020"²², që, ndër të tjera, ka si përparësi strategjike promovimin e "përdorimit të gjerë të të dhënave statistikore midis përfituesve". Aktivitetet në kuadër të këtij prioriteti janë:

- Zhvillimi dhe promovimi i dialogut me përdoruesve;
- Promovimi i përdorimit të të dhënave statistikore përmes përmirësimit të aksesit tek të dhënat dhe informacioni;
- Krijimi i zonave statistikore në bazë të bashkëpunimit në mjedisin e brendshëm dhe ndërkombëtar.

Për të përmbushur këto prioritetet ka një numër masash të propozuara, të cilat mund të shfrytëzohen për të arritur një qasje më sistematike në mbledhjen e të dhënave në lidhje me OShC-të në përgjithësi, dhe të dhënat ekonomike/financiare të sektorit në veçanti.

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Bosnje-Herzegovinë

Popullsia (censusi i popullsisë, 2013 – të dhëna paraprake) ²³	3,791,622
Numri i OShC-ve në 2014 ²⁴	12,000
Numri i qytetarëve për OShC	315.97
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Bosnje-Herzegovinë (2014)
PBB ²⁵	13,667,000,000
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	N/A
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	N/A
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve	N/A
Shpenzimet për tatime (TVSH+tatimi mbi të ardhurat personale+tatimi mbi fitimin)	N/A
Numri i të punësuarve në OShC	N/A
Numri i përgjithshëm i të punësuarve	N/A
Të punësuarit në OshC në raport me punësimin e përgjithshëm (%)	N/A
Numri i të punësuarve për OShC	N/A
Numri i vullnetarëve	N/A

1 EUR = 1.95583 BAM

²²<http://www.bhas.ba/planiprogram/STRATEGIJA%20%20RAZVOJA%20STATISTIKE%20BIH%202020FINAL%20BH.pdf>

²³ http://www.bhas.ba/obavjestenja/Preliminarni_rezultati_bos.pdf

²⁴ Përafrim;

²⁵ <http://countryeconomy.com/countries/bosnia-herzegovina>

Siç përmendet dhe më sipër, të dhënat mbi OShC-të janë pothuaj jo-ekzistente (publikisht). Megjithatë, në faqen e internetit të Agjencisë së Statistikave të Bosnje-Hercegovinës, publikimi “Njësitë statistikore të regjistrit të biznesit”, botuar në 30 qershor 2014²⁶ përmban statistika rreth bizneseve të ndryshme, ku përfshihen dhe jofitimprurëset, të cilat janë të identifikueshme nëpërmjet Fushës ‘S - lloje të tjera të shërbimeve’²⁷ dhe Kodit zyrtar ‘94 - organizatat me bazë anëtarësimi’, në përputhje me Klasifikimin e aktivitetve në Bosnje-Hercegovinë.²⁸

Brenda Kodit 94, llojet e mëposhtme të OShC-ve do të mund të identifikohen:

94.1 Aktivitetet e shoqatave të biznesit, shoqatave të punëdhënsve dhe shoqatave të ekspertëve me bazë anëtarësimi

94.11 Aktivitetet e shoqatave të biznesit dhe shoqatave të punëdhënsve

94.12 Aktivitetet e shoqatave të ekspertëve me bazë anëtarësimi

94.2 Aktivitetet e organizatave sindikale

94.20 Aktivitetet e organizatave sindikale

94.9 Aktivitetet e shoqatave të tjera me bazë anëtarësimi

94.91 Aktivitete e organizatave fetare

94.92 Aktivitetet e organizatave politike

94.99 Aktivitetet e organizatave të tjera me bazë anëtarësimi.

Në Bosnje-Hercegovinë, në 2014 kishte 14,601 njësi nën Kodin 94. Nga ky numër 2,303 (ose 15.8%) dhe 1,764 (ose 12.1%) kanë dorëzuar raporte financiare. 12,298 (ose 84.2%) nuk janë mbyllur, edhe pse nuk kanë dorëzuar raportet e tyre financiare, dhe në mesin e tyre 7,592 (ose 61.7%) kanë llogari aktive.

Në të njëjtin publikim, të dhënat për punësimin mbulojnë të gjithë fushën ‘S’.

Duke qenë se OShC-të përfshihen në fushën ‘S’ dhe Kodin 94 (të paktën kodet 94.1 dhe 94.99), është e arsyeshme të supozojmë se statistikat në lidhje me OShC-të mblidhen në mënyrë të rregullt nga Agjencia e Statistikave (nëse ekziston një marrëveshje që saktëson se cilat nënkode të Kodit 94 përfaqësojnë OShC-të).

²⁶ http://www.bhas.ba/saopstenja/2014/SPR_2014_001_01-bh.pdf

²⁷ Përfshin tre kode: 94, 95 dhe 96.

²⁸ <http://dissemination.bhas.ba/classifications/kdbih.aspx?l=e>

Rekomandime për Bosnje-Hercegovinën

- Krijimi i një regjistri unik të OShC-ve në Bosnje-Hercegovinë me klasifikimin e qartë të OShC-ve si një sektor i veçantë me karakteristika dalluese;
- Publikimi i rregullt i statistikave bazë mbi sektorin jofitimprurës, duke qenë se këto të dhëna tashmë mblidhen nga organet përkatëse (të ardhurat e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, shpenzimet e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, të dhëna të disagreguara mbi punësimin në sektor: numri i të punësuarve në total dhe sipas llojit të kontratës, paga mesatare...);
- Ofrimi i të dhënave pa pagesë, në një dokument publik të aksesueshëm në faqet e internetit të institucioneve përkatëse. Grumbullimi i të dhënave në një dokument unik do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt paraqitjes së të dhënave ekonomike për sektorin;
- Reflektimi i rëndësisë dhe nevojës për mbledhjen sistematike të të dhënave, botimin dhe analizën e tyre në dokumentet strategjike që lidhen me OShC-të (p.sh. Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnje-Hercegovinës dhe sektorit jofitimprurës, 2004);
- Mbledhja sistematike e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe zhvillimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB;
- Shfrytëzimi i prioriteteve të “Strategjisë për zhvillimin e statistikave në Bosnje-Hercegovinë 2020” si një mjet advokimi për një qasje më sistematike në mbledhjen e të dhënave për OShC-të, analizimin dhe publikimin e tyre në përgjithësi.

Kosova

Gjendja e mbledhjes së statistikave

Burime të mundshme të informacionit mbi vlerën ekonomike të sektorit jofitimprurës në Kosovë janë Agjencia e Statistikave, Banka Qendrore, Shoqata e Bankave të Kosovës, Administrata Tatimore dhe Trusti i Kursimeve Pensionale. Sidoqoftë, të dhëna të disponueshme për publikun mungojnë dhe partneri zbatues i projektit, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka ndërmarrë përpjekje të përsëritura për të marrë përgjigje ndaj kërkesave të tij për informacion.

Ndërsa Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) mundësoi disa të dhëna nga viti 2013, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPT) ofroi statistika të reja dhe më të detajuara në lidhje me punësimin për vitin 2014. Për të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme, ka një mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet ASK-së dhe TKPT-së dhe si pasojë e hijeve të dyshimit mbi vërtetësinë e tyre, këto të dhëna nuk paraqiten në raport. Të dhënat mbi të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve janë të disponueshme nga Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile që botohet çdo dy vjet nga KCSF. Megjithatë, këto të dhëna mbeten vlerësime, të bazuara në një kampion prej 100 OShC aktive dhe nuk mbulojnë të gjithë sektorin. Për këtë arsye, ato gjithashtu nuk përdoren në raport.

“Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017” ka një referencë mbi mungesën e statistikave për sektorin, duke vënë në dukje se “Llogaritet që rreth 8% të fondeve për shoqërinë civile kanë ardhur nga buxheti i Republikës së Kosovës, ndërsa statistika të sakta për fondet për shoqëri civile të dhëna nga niveli qeveritar nuk ka.” Rishikimi i strategjisë është planifikuar të kryhet çdo dy vjet,²⁹ kështu që duhet shfrytëzuar kjo mundësi për të mundësuar përfshirjen e nevojës së pasjes së një sistemi për mbledhjen e të dhënave mbi OShC-të (të lidhura këto jo vetëm me aspektin ekonomik, por për sektorin në përgjithësi).

Duke qenë se strategjia e njeh vullnetarizmin si një nga katër prioritetet kyçe të saj, mund të ndërmerren përpjekje të tjera të ngjashme në lidhje me të dhënat mbi vullnetarizmin në procesin e rishikimit të strategjisë.

²⁹ Dy vitet e para të zbatimit të Strategjisë përfundojnë në 2015, kështu që 2016 do t'i kushtohet rishikimit.

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Kosovë

Popullsia (projeksion për 2014) ³⁰	1,844,553
Numri i OShC-ve në 2014 ³¹	8,014
Numri i qytetarëve për OShC	230
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Kosovë (2014)
PBB ³²	5,326,700,000
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	N/A
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	N/A
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve	N/A
Shpenzimet për tatime (TVSH+tatimi mbi të ardhurat personale+tatimi mbi fitimin)	N/A
Numri i të punësuarve në OShC ³³	8,743
Numri i përgjithshëm i të punësuarve ³⁴	338,400
Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%)	2.58%
Numri i të punësuarve për OShC	1.09
Numri i vullnetarëve	N/A
Numri i përgjithshëm i kontributeve individuale në sektorin e OJQ-ve	12,874
Numri i të punësuarve me më shumë se një punësim, nga ku një është në OJQ	4,583
Vlera e përgjithshme e kontributeve të punësuarve në OJQ	3,561,897.52
Ndarja e kontributeve sipas gjinisë	Meshkuj: 7,076 Femra: 5,798

Sipas të dhënave të marra nga Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhjen me OJQ (DRNOJQ) në 31 dhjetor 2014, në Kosovë ka 8014 OShC të regjistruara. Megjithatë, KCSF vlerëson se vetëm 15-20% e tyre (rreth 1500 OShC) janë aktive. Ky vlerësim bazohet në kombinimin e disa faktorëve: OShC-të që kanë deklaruar të punësuarit e tyre në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, OShC-të e regjistruara rishtas (në vitin 2014) dhe pjesës së vogël të OShC-ve që punojnë me bazë vullnetare, pa staf të paguar.

Trusti Pensional i Kursimeve të Kosovës ka dhënë informacion rreth numrit të personave që paguajnë kontributet e detyrueshme (pensionale) nga OJQ-të (numri i përgjithshëm është 12,874 për vitin 2014³⁵), dhe numrin e të punësuarve me më shumë se një punë, një prej të cilave është në OJQ (4583). Këto të dhëna mundësojnë

³⁰ https://ask.rks-gov.net/ENG/publikimet/doc_download/1322-estimation-kosovo-population-in-2014

³¹ Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhjen me OJQ, 31 dhjetor 2014

³² http://ask.rks-gov.net/ENG/national-account/publications/doc_download/1328-quarterly-gross-domestic-product-q1-2015


³³ Punësimi vetëm në OShC.

³⁴ http://ask.rks-gov.net/ENG/labour-market/publications/doc_download/1199-results-of-the-kosovo-2013-labour-force-survey

³⁵ Deri në 2014, të dhënat mbi punësimin për Agjencinë e Statistikave të Kosovës sigurohen nga Trusti Pensional i Kursimeve të Kosovës.

llogaritjen e numrit të punësuarve që angazhohen vetëm në sektorin e OJQ-ve, i cili është 8743.

Struktura e të punësuarve në sektorin e OShC-ve në Kosovë, sipas gjinisë



Nga numri i kontributeve të përgjithshme individuale, 7076 (56%) janë meshkuj dhe 5798 (45%) janë femra.

Punësimi në sektorin e OShC-ve është mjaft i lartë nëse krahasohet me vendet e tjera. Vlen të theksohet se statistikat në dispozicion e bëjnë të mundur dallimin midis punësimit vetëm në sektorin e OShC-ve dhe punësimit paralel në OShC dhe sektorë të tjerë të ekonomisë. Përqindja e të punësuarve në sektorin jofitimprurës në raport me punësimin e përgjithshëm në Kosovë është 3.8% (duke përfshirë këtu dhe ata që janë të angazhuar në punësim paralel), ndërsa përqindja e të punësuarve vetëm në sektorin jofitimprurës është 2.58%, që mbetet ende përqindja më e lartë midis vendeve të mbuluara në raport. Megjithatë, një metodologji që do të bënte dallimin e qartë midis numrit të punësuarve me kohë të plotë dhe numrit të punësuar me kohë të pjesshme në sektor mungon.

Vlera e përgjithshme e kontributeve nga të punësuarit në OShC-të në Kosovë është 3,561,897.52 euro.

Duke qenë se nuk ka të dhëna mbi të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve, vlerësimi kontributit të sektorit në PBB nuk është i mundur.

Përsa lidhet me statistikat mbi vullnetarizmin, nuk ka të dhëna sistematike e gjithëpërfshirëse mbi numrin e vullnetarëve, orët e punës vullnetare dhe vlerën e tyre monetare.

Rekomandime për Kosovën

- Fillimi i procesit të mbledhjes së të dhënave mbi OShC-të nga organet përkatëse duke përdorur një kategorizim të veçantë të sektorit në sistemet e tyre statistikore;
- Vendosja e një komunikimi të rregullt midis organeve përgjegjëse për mbledhjen e statistikave. Në këtë kontekst, është me rëndësi identifikimi dhe kapërcimi i problemeve pas mospërputhjes në të njëjtat lloj të dhënash nga ana e institucioneve/organeve të ndryshme;
- Sigurimi i një informacioni transparent rreth llojit të statistikave të mbledhura nga institucionet/organet e ndryshme në lidhje me performancën ekonomike të OShC-ve;
- Zhvillimi dhe/ose prezantimi para publikut i një metodologjie të qartë që identifikon llojin e punësimit brenda sektorit;
- Ofrimi i të dhënave pa pagesë, në një dokument publik të aksesueshëm në faqet e internetit të institucioneve përkatëse. Grumbullimi i të dhënave në një dokument unik do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt paraqitjes së të dhënave ekonomike për sektorin;
- Reflektimi i rëndësisë dhe nevojës për mbledhjen sistematike të të dhënave, botimin dhe analizën e tyre në dokumentet strategjike që lidhen me OShC-të (p.sh. në ‘Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë. Civile 2013-2017’)³⁶. Rishikimi i Strategjisë aktuale duhet të shfrytëzohet për të adresuar çështjen e mungesës së të dhënave të lidhura me sektorin;
- Mbledhja sistematike e statistikave mbi vullnetarizmin, si dhe zhvillimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB. Kjo duhet të reflektohet në rishikimin e Strategjisë aktuale.

³⁶ Miratuar në 2013.

Maqedonia

Gjendja e mbledhjes së statistikave

Sipas Matricës së Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Maqedoninë 2014,³⁷ disponueshmëria e të dhënave mbi shoqërinë civile në nivel kombëtar është e kufizuar (statistika në lidhje me sektorin mund të sigurohen përkundrejt pagesës në varësi të nivelit të detajimit të tyre).

Procesi i regjistrimit të OShC-ve realizohet në përputhje me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet³⁸ që mundëson regjistrimin e organizatave përmes Regjistrimit Qendror të Republikës së Maqedonisë. Duke qenë përgjegjës për administrimin e të dhënave të veçanta mbi performancën financiare të OShC-ve në Maqedoni, Regjistri Qendror është një nga burimet kryesore të të dhënave mbi shoqërinë civile. Sidoqoftë, këto të dhëna nuk janë të disponueshme për publikun dhe duhet të sigurohen përkundrejt pagesës (të dhënat e përdorura në këtë raport kanë kushtuar 980 euro).

Enti Shtetëror i Statistikave në Maqedoni është organi përgjegjës kryesor për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore në lidhje me karakteristikat demografike, sociale dhe ekonomike të shoqërisë maqedonase. Për sektorin jofitimprurës, disa nga të dhënat financiare për OShC-të në Maqedoni janë të disponueshme për publikun (p.sh. pagat mesatare) dhe mund të aksesohen në botimet e Entit Shtetëror të Statistikave. Megjithatë, këto statistika agregojnë të gjitha llojet e organizatave jofitimprurëse së bashku (i.e. të gjitha organizatat me bazë anëtarësimi).

Në vitin 2014, u ngrit Këshilli i Statistikave si një organ ndërsektorial me përfshirjen e një përfaqësuesi të shoqërisë civile – mundësi kjo që mund të përdoret për të avancuar më tej nevojën për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi OShC-të.

Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm informacioni në lidhje me sektorin jofitimprurës janë dhe institucionet e ndryshme shtetërore, ku të dhënat mund të sigurohen përmes ligjit “Për qasje të lirë në informacione me karakter publik”³⁹ dhe ligjit “Për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik.”⁴⁰ Megjithatë, mundësitë e ofrura nga këto ligje mbeten të reja dhe ende të pashfrytëzuara. Për të siguruar të

³⁷ <http://monitoringmatrix.net/monitoring-matrix/civil-society-and-civil-society-development-in-macedonia-2014/>

³⁸ Ligji “Për shoqatat dhe fondacionet” (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.52/2010 dhe 135/2011”).

³⁹ Ligjit “Për qasje të lirë në informacione me karakter publik” (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.13/2006, 86/2008, 6/2010, dhe 42/2014”).

⁴⁰ Ligji “Për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik.” (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.27/2014”).

dhëna nga organet shtetërore (raporte, dokumente, opinione, përvoja, etj), nevojiten përpjekje shtesë, të cilat nganjëherë kthehen në të padobishme për shkak të mospërfilljes nga ana e organeve shtetërore.

Në dokumentin më të fundit strategjik “Strategjia për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil 2012-2017” rëndësia dhe nevoja për përmirësimin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave në lidhje me sektorin nuk përmendet.

OShC-të lokale mund të jenë një burim të dhënash duke zhvilluar anketa të ndryshme (për shembull, për vlerësimin e numrit të vullnetarëve), por këto anketa realizohen në mënyrë sporadike.

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Maqedoni

Popullsia (13.12.2014) ⁴¹	2,069,172
Numri i OShC-ve në 2014 ⁴²	4,156
Numri i qytetarëve për OShC	498
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Maqedoni (2014)
PBB ⁴³	8,535,000,000
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	0.96%
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	81,516,756
Struktura e të ardhurave	
Të ardhura të përgjithshme nga shitja e produkteve	5,169,488
Të ardhura të përgjithshme nga shërbimet	4,687,735
Të ardhura të përgjithshme nga donacionet dhe grantet	55,477,219
Të ardhura të përgjithshme të vetë-generuara	124,072
Të ardhura të tjera	16,058,242
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve	60,226,397
Struktura e shpenzimeve	
Pagat dhe shpenzime të tjera të lidhura me pagat	9,875,892
Shpenzime për honoraret	3,214,950
Shpenzime për detyrat me kohë të pjesshme	4,716,287
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	220,402
Mbështetje, donacione dhe dhurime të tjera	7,263,132
Shpenzime të tjera	34,935,733
Shpenzime për të punësuarit	9,875,892
Shpenzimet për tatime (TVSH+tatimi mbi të ardhurat personale + tatimi mbi fitimin)	N/A ⁴⁴

⁴¹ http://www.stat.gov.mk/Default_en.aspx

⁴² Sipas të dhënave nga Regjistri Qendror i Maqedonisë (CRM) për 2014 kishte 13,656 shoqata dhe fondacione, nga ku 4,156 janë të ri-regjistruara sipas ndryshimeve në ligjin “Për shoqatat dhe fondacionet” (dhe janë me shumë gjasa aktive).

⁴³ <http://countryeconomy.com/countries/macedonia>


⁴⁴ Të dhënat nuk mund të siguroheshin.

Numri i të punësuarve në OShC	1,897
Numri më i madh i të punësuarve në 1 OShC në 2014	42
Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%) ⁴⁵	0.38%
Paga mesatare (neto) ⁴⁶	348
Paga mesatare (bruto) ⁴⁷	509
Numri i vullnetarëve	N/A
Numri i përgjithshëm i OShC-ve të regjistruara	13,656
Numri i përgjithshëm i OShC-ve të ri-regjistruara	4,156
Numri i OShC-ve që dorëzuan raporte financiare në 2014	1,388
Numri i OShC-ve që dorëzuan vetëm deklarata/vendime në 2014 ⁴⁸	2,550

1 EUR= 61.505 MKD

Siç citohet në Raportin e Matricës së Monitorimit, "Sipas të dhënave të dhjetorit 2014 të Regjistrimit Qendror të Maqedonisë (CRM), numri i organizatave jofitimprurëse të regjistruara (shoqata dhe fondacione) është 13,656 ose 6.6 organizata për 1000 qytetarë." Nga ky numër, 4,156 organizata janë ri-regjistruar sipas ligjit "Për shoqatat dhe fondacionet" të miratuar në 2010. Nëse nga ky numër përjashtohen shoqatat sportive (rreth 30%), ka rreth 1,000 organizata aktive në sektore dhe rajone të ndryshme të Maqedonisë. Në këtë raport përdoret numri i organizatave të ri-regjistruara, i.e. 4.156 OShC.

Struktura e të ardhurave të OShC-ve, 2014



⁴⁵ <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.15.05.pdf>

⁴⁶ <http://www.stat.gov.mk/>

⁴⁷ <http://www.stat.gov.mk/>

⁴⁸ Sipas Ligjit mbi kontabilitetin për organizatat jofitimprurëse ("Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.24/2004, 17/2011, 154/2015") neni 18, OShC-të me një vlerë kapitali ose të ardhura vjetore më pak se 2500 euro nuk janë të detyruara të dorëzojnë raportet financiare.

Sipas CRM, nga numri i përgjithshëm i OShC-ve të regjistruara (13,656), 29% kanë dorëzuar raporte financiare ose deklarata të shpenzimeve të tyre, që përbëjnë dhe 95% të numrit të përgjithshëm të OShC-ve të ri-regjistruara (4,156). Dorëzimi i raporteve financiare ose i deklaratave kontribuon drejt rritjes së saktësisë së numrit të organizatave të ri-regjistruara, megjithatë nuk nënkupton se të gjitha këto organizata janë domosdoshmërisht aktive.

Nga numri i përgjithshëm i OShC-ve vetëm 1388 kanë dorëzuar raporte financiare, shifër që përbën 10% të totalit të OShC-ve dhe 33% të OShC-ve të ri-regjistruara. Kjo tregon se pjesa më e madhe e organizatave kanë një buxhet vjetor më të vogël se 2,500 euro dhe fondet përqëndrohen midis organizatave më "të mëdha".


Në vitin 2014, të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve arrinin në 81,516,756 euro, me pjesën më të madhe të fondeve nga donacionet dhe grantet (68%), ndjekur nga të ardhurat e tjera (20%). Të ardhurat nga shërbimet dhe nga shitja e produkteve gjeneruan së bashku vetëm 6% të të ardhurave të përgjithshme. Sektori jofitimprurës është kryesisht i varur nga donacionet dhe grantet dhe angazhohet më pak në aktivitete ekonomike.

Në Maqedoni, të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve përbënin 0.96% të PBB-së kombëtare⁴⁹ për 2014. Nëse krahasohet me vendet e tjera të mbuluara nga ky raport, kjo është një shifër e rëndësishme që tejkalohet vetëm nga Turqia.

Të ardhurat mesatare për OShC-të ishin 19,614 euro (të ardhurat mesatare janë llogaritur duke pjestuar të ardhurat e përgjithshme me numrin e OShC-ve të ri-regjistruara). Nëse të ardhurat e përgjithshme do të pjestoheshin me numrin e OShC-ve që kanë dorëzuar raportet e tyre financiare, të ardhurat mesatare për OShC do të ishin dukshëm më të larta (58,730 euro).

⁴⁹ <http://countryeconomy.com/gdp/macedonia>

Struktura e shpenzimeve të OShC-ve, 2014



Ndërkohë, shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve arrinin në 60,226,397 euro, ku "Shpenzimet e tjera" zinin 59% të shpenzimeve dhe mbulonin zëra si: tarifat mbi transaksionet e pagesave, interesat për kredi, primet e sigurimeve, dietat ditore dhe shpenzimet e udhëtimeve, rimbursimet e kostove të të punësuarve dhe qytetarëve, diferencat negative nga kursi i këmbimit, anëtarësimet, shpenzimet për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe fondet e transferuara. Pagat dhe shpenzimet e tjera të lidhura me pagat përfaqësonin 16% të shpenzimeve, ndjekur nga mbështetjet dhe donacionet (12%), shpenzimet për detyrat me kohë të pjesshme (8%) dhe shpenzimet për honorare (5%). Vlen të theksohet se të gjitha shpenzimet që lidhen me pagat/honoraret përbëjnë pothuaj një të tretën e totalit (30%). Shpenzimet mesatare për OShC-të e ri-regjistruara ishin 14,491 euro, ndërsa për OShC-të që kishin dorëzuar raportet e tyre financiare 43,391 euro.

Numri zyrtar i të punësuarve për 2014 ishte 1,897 të punësuar, ose 0.38% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Maqedoni – një përqindje e ngjashme me Malin e Zi dhe Serbinë. OShC-të e ri-regjistruara kishin mesatarisht 0.46 të punësuar me kohë të plotë, përkundrajt 1.4 të punësuarve për OShC-të me raporte financiare të dorëzuara. Ndërkohë, ka më shumë njerëz të angazhuar pranë OShC-ve me lloje të ndryshme kontratash punësimi, por të dhënat nuk janë të disponueshme dhe mbetet e paqartë nëse ato mund të sigurohen nga Fondi Pensional apo Enti i Statistikave. Numri relativisht i vogël i të punësuarve tregon për mungesën e një baze të qëndrueshme të burimeve njerëzore ku sektori mund të zhvillohet dhe mbështetet.

Nuk ka të dhëna të disponueshme mbi numrin zyrtar të vullnetarëve. Statistikat nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) bazohen në numrin e kartave të

vullnetarëve të emetuara. Megjithatë, qysh nga fundi i vitit 2014, Ministria ka ndaluar së lëshuari karta vullnetare, prandaj bëhet e vështirë llogaritja e një numri të saktë të vullnetarëve. Për momentin, ky numër mund të llogaritet vetëm përmes anketave të OShC-ve, por edhe këto statistika mbeten përshkruese dhe të pjesshme. Për shembull, studimi i kryer nga një OShC lokale Reaktor-Reserch In Action⁵⁰ tregon se për vitin 2014, 17% e qytetarëve deklarojnë të jenë anëtarë të ndonjë organizate. Ndërkohë, studimi “Përgjegjësia sociale e qytetarëve 2013” i realizuar nga MCIC, përdori një kampion përfaqësues për të gjeneruar të dhëna mbi indeksin e aktiviteteve vullnetare në komunitet (18.4%) dhe indeksin e pjesëmarrjes në OShC (17.6 %).

Rekomandime për Maqedoninë

- Përshtatja e formularëve ekzistues të regjistrimit ndaj specifikave të OShC-ve;
- Botimi i statistikave bazë mbi jofitimprurëset nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë (CROM). Në botim duhet të përfshihen të dhënat ekonomike mbi sektorin jofitimprurës, duke qenë se këto të dhëna mblidhen tashmë nga CRM (të ardhurat e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, shpenzimet e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, të dhëna të disagreguara mbi punësimin në sektor: numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe sipas llojit të kontratës, paga mesatare, etj);
- Ofrimi i të dhënave pa pagesë, në një dokument publik të aksesueshëm në faqen e internetit të CRM-së;
- Shqyrtimi i mundësisë që Enti Shtetëror i Statistikave të mbledhë, përpunojë dhe publikojë të dhëna statistikore specifike në lidhje me sektorin jofitimprurës;
- Rritja e rolit të përfaqësuesit të OShC-ve në Këshillin e Statistikave për të bërë të mundur promovimin e nevojës dhe rëndësisë së mbledhjes së statistikave për OShC-të, si dhe analizimin dhe prezantimin e tyre në programet statistikore;
- Shqyrtimi i mundësisë për të promovuar Njësinë për bashkëpunim me OJQ-të si lehtësuese në marrjen e të dhënave specifike për shoqërinë civile që nuk mblidhen në mënyrë të rregullt;
- Monitorimi dhe shqyrtimi i të dhënave të hapura për OShC-të nga ana e institucioneve (duke përdorur ligjin “Për qasje të lirë në informacione me karakter publik” dhe ligjin “Për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik”);
- Reflektimi i rëndësisë dhe nevojës për mbledhjen sistematike të të dhënave, botimin dhe analizën e tyre në dokumentet strategjike që lidhen me OShC-të (p.sh. Strategjia për bashkëpunim me shoqërinë civile, Partneriteti për Qeverisje

⁵⁰ http://www.graganskoucestvo.mk/static/pdf/gragjansko_uchestvo2012-1014_mkd.pdf

të Hapur, etj.). Rishikimi i këtyre dokumenteve rekomandohet si një nga prioritetet e advokacisë.

- Mbledhja sistematike e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe zhvillimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB.

Mali i Zi

Gjendja e mbledhjes së statistikave

Në Mal të Zi, gjendja e mbledhjes së të dhënave mbi sektorin jofitimprurës, analizimin dhe publikimin të tyre ka tri karakteristika kryesore, të përshkruara si më poshtë vijon:

Së pari, në asnjë vend tjetër (nga vendet e paraqitura në këtë raport) nuk ka një person kontakti për OJQ-të të caktuar zyrtarisht si në Zyrën Statistike të Malit të Zi.⁵¹ Baza ligjore për fushën e aktivitetit të personit përgjegjës për bashkëpunimin me OJQ-të gjendet në nenin 16 të “Dekretit për mënyrën dhe procedurën për bashkëpunimin e organeve të Administratës Publike me organizatat joqeveritare” (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi 07/12). Ky dekret përcakton se çdo organ i administratës publike duhet të ketë një person përgjegjës për bashkëpunimin me OShC-të. Të dhënat e kontaktit të këtij personi duhet të jenë të afishuara në faqen e internetit të organit përkatës të administratës publike.

Së dyti, me përjashtim të Maqedonisë, Mali i Zi është i vetmi vend me një përfaqësues të sektorit jofitimprurës në Këshillin Statistikor, siç parashikohet dhe në dekretin e sipërpërmendur. “Me qëllim përmirësimit e kulturës dhe njohurive statistikore, si dhe përmbushjen e nevojave të përdoruesve të statistikave zyrtare, Qeveria do të ngrejë Këshillin e Sistemit Statistikor (i cili më poshtë do të quhet "Këshilli") si një organ këshillues dhe profesional, siç përcaktohet në Kapitullin IV të Ligjit të statistikave zyrtare dhe sistemit zyrtar statistikor” (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi 18/12).⁵² Kjo nënkupton pasjen e një mundësie të vërtetë për sektorin jofitimprurës për të ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e sistemit statistikor në Mal të Zi.

Së treti, edhe pse këto dy aspekte potencialisht pozitive bëjnë të mundur pasjen e të dhënave të disponueshme dhe transparente, në “Strategjinë për Zhvillimin e Organizatave Jo-Qeveritare në Mal të Zi, 2014-2016”⁵³ miratuar në mbledhjen e qeverisë të datës 26 dhjetor 2013, situata e statistikave mbi OShC-të konsiderohet e dobët. Nën qëllimin strategjik 4.4. Mjedisi mundësues për punën e organizatave jo-qeveritare i.e. 4.4.5. Statistikat dhe të dhënat për OJQ-të, gjenden prioritetet dhe masat që duhet të përmbushen në këtë drejtim. Në këtë kapitull, thuhet si vijon: "Statistikat dhe të dhënat mbi organizatat jo-qeveritare nuk rregullohen në mënyrë të dallueshme

⁵¹ Kontakti me OJQ-të: Vasiljević Ana, Drejtore e administratës, burimeve njerëzore dhe financës; Tel +382 20/226-534; Fax +382 20/230-7814; e-mail: ana.vasiljevic@monstat.org;

⁵² <http://www.monstat.org/eng/page.php?id=1035&pageid=1>

⁵³ <http://www.monstat.org/eng/page.php?id=14&pageid=14>

⁵³ <http://www.osce.org/montenegro/124433>

në ligjet e aktet nënligjore dhe në procedurat e brendshme të organeve kompetente të administratës shtetërore. Një nga pengesat e mëdha për marrjen në konsideratë të nevojave dhe funksionimit të OJQ-ve në Mal të Zi, veçanërisht në aspektin e zhvillimit të tyre, është mungesa e të dhënave zyrtare mbi të punësuarit dhe vullnetarët, të ardhurat (donacione nga burime të brendshme dhe ndërkombëtare, aktivitete ekonomike, pagesat e anëtarësisë etj.), e zyrave për punën e tyre, dhe e pajisjeve teknike. Kjo e metë e vështirëson procesin e planifikimit të drejtimeve të mëtejshme të zhvillimit të OShC-ve dhe mbështetjes që organet shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore duhet t'u ofrojnë OShC-ve.”

Duke u bazuar në përshkrimin e mësipërm, nevojitet të shqyrtohet mundësia për të monitoruar të dhëna të caktuara që lidhen me specifikat e punës së OShC-ve dhe përfshirjen e tyre në sistemin e të dhënave që ruhen ex officio nga organet kompetente për statistikat. U identifikua nevoja për të amenduar Ligjin për Kontabilitetin dhe Auditin, veçanërisht në pjesën e lidhur me grupin e personave juridikë ku ligji aplikohet dhe specifikat e plotësimit të llogarive përfundimtare nga OShC-të. Kjo do të çojë në sigurimin e të dhënave të rëndësishme për aktivitetet monitoruese, strukturën e stafit dhe veprimet financiare të OShC-ve në Mal të Zi që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në transparencën dhe zhvillimin e tyre.

Për më tepër, Plani i veprimit për Kapitullin 23 të Acquis BE njih nevojën për përmirësimin e situatës në këtë fushë.

Në praktikë, është e mundur të sigurohen disa të dhëna që tashmë mblidhen, si numri i OShC-ve që dorëzojnë raporte financiare, të ardhurat e përgjithshme, shpenzimet e përgjithshme, struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve, numri i të punësuarve dhe pagat mesatare. Megjithatë, këto të dhëna nuk përpunohen dhe botohen posaçërisht për sektorin e OShC-ve.

Përveç Zyrës Statistike, burimet e mundshme për statistikat e lidhura me OShC-të në Malin e Zi janë Ministria e Financave/Administrata Tatimore dhe Fondet Pensionale dhe të Paaftësisë.

Siç është shpjeguar tashmë për rastin e Bosnje-Hercegovinës, subjektet ligjore mund të identifikohen lehtësisht përmes kodeve të përcaktuara nga klasifikimi i aktiviteteve. Në Malin e Zi⁵⁴ OShC-të mund të identifikohen në Sektorin "S" - Shërbime të tjera - Fusha 94, e cila trajton organizata "që përfaqësojnë interesat e grupeve të veçanta ose që promovojnë idetë e tyre. Këto organizata zakonisht funksionojnë me bazë

⁵⁴ <http://www.monstat.org/userfiles/file/klasifikacije/2.%20Publikacija%20KD%202010.pdf>

anëtarësimi, por shumëkush mund t'u bashkohet aktiviteteve të tyre nëse është i interesuar."

Brenda Fushës 94, këto organizata mund të identifikohen më tej si ato që u shërbejnë interesave të punëmarrësve, të vetë-punësuarve dhe komuniteteve shkencore (9411, aktivitetet e shoqatave të biznesit dhe shoqatave të punëdhënësve; 9412, aktivitetet e shoqatave të ekspertëve dhe 9499, aktivitetet e organizatave të tjera me bazë anëtarësimi – promovimi i ideve dhe aktiviteteve që lidhen me aktivitetet fetare, politike, kulturore, arsimore apo rekreative).

Statistikat e bazuara në klasifikimin e aktiviteteve tashmë mblidhen dhe botohen në publikime të ndryshme, prandaj është e arsyeshme të supozohet që përpunimi i të dhënave në mënyrë specifike për OShC-të është i mundur (nëse supozimi për kodet është i saktë dhe OShC-të mund të identifikohen lehtë nga këto kode). Në mënyrë të ngjashme, të dhënat për të punësuarit mblidhen rregullisht nga Fondi Pensional dhe i Paaftësisë⁵⁵ (duke u bazuar në pyetësorë specifikë që çdo punëdhënës i dorëzon këtij organi për punëmarrësit e tij çdo muaj). Ky përfaqëson, pra, një tjetër burim të mundshëm të dhënash që mund të jenë të disponueshme sipas kërkesës. Vlen për t'u shqyrtuar nëse OShC-të kanë një kod unik që i diferencon ato nga subjektet e tjera ligjore.

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Mal të Zi

Të gjitha të dhënat ekonomike në tabelën më poshtë (si dhe në tekstin shoqërues që vijon) u referohen 1,137 OShC-ve që kanë dorëzuar për 2014 raportet e tyre financiare tek Administrata Tatimore. Ato përbëjnë 34.5% të numrit të përgjithshëm të OShC-ve të regjistruara.

Popullsia (censusi i popullsisë 2011) ⁵⁶	620,029
Numri i OShC-ve në 2014 ⁵⁷	3,300
Numri i qytetarëve për OShC	188
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Mali i Zi (2014)
PBB ⁵⁸	3,425,000,000
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	0.58%
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	19,889,292
Të ardhura të përgjithshme nga aktiviteti ekonomik ⁵⁹	3,016,225

⁵⁵ <http://www.fondpio.me>

⁵⁶ <http://monstat.org/userfiles/file/publikacije/godisnjak%202014/stanovnistvo.pdf>

⁵⁷ Regjistri i OJQ-ve: <http://www.dokumenta.me/nvo/>


⁵⁸ <http://countryeconomy.com/countries/montenegro>

Të ardhura të përgjithshme nga donacione dhe grante	15,876,546
Të ardhura të tjera	996,521
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve ⁶⁰	N/A
Shpenzime për tatime	2,412,946
Numri i të punësuarve në OShC ⁶¹	776
Numri i përgjithshëm i të punësuarve ⁶²	210,900
Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%)	0.37%
Numri i të punësuarve për OShC	0.24
Numri i vullnetarëve	N/A

Sipas të dhënave zyrtare, në vitin 2014 në Mal të Zi kishte 3,300 OShC, nga të cilat 3104 ishin OJQ (94.1%), 99 fondacione jo-qeveritare (3%) dhe 97 (2.9%) zyrat të përfaqësimit të OJQ-ve të huaja.

Numri mesatar i qytetarëve për organizatë është 188, që është dhe mesatarja më e ulët në krahasim me vendet e tjera.

Struktura e të ardhurave të OShC-ve, 2014



Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve për vitin 2014 ishin 19,889,292 euro, nga ku rreth 80% vinin nga donacionet dhe grantet, 15% nga aktivitetet ekonomike (shitja e të

⁵⁹ Sipas të dhënave nga administrata tatimore, një OShC raportoi të ardhura nga aktiviteti ekonomik në shumën e 1,586,023 euro. Duke qenë se kjo është një shumë mjaft e madhe për 1 OShC, CRNVO ka kërkuar sqarim dhe informacion shtesë nga administrata tatimore, por ishte ende në pritje të një përgjigje kur ky raport po shkruhej.

⁶⁰ Sipas të dhënave nga administrata tatimore, një OShC raportoi të ardhura nga aktiviteti ekonomik në shumën e 1,586,023 euro. Duke qenë se kjo është një shumë mjaft e madhe për 1 OShC, CRNVO ka kërkuar sqarim dhe informacion shtesë nga administrata tatimore, por ishte ende në pritje të një përgjigje kur ky raport po shkruhej.

⁶¹ Sipas të dhënave nga administrata tatimore, të datës 8 shtator 2015. Megjithatë këto të dhëna i referohen vetëm të punësuarve që kanë tog-fjalëshin 'jo-qeveritare' në titullin e tyre.

⁶² <http://monstat.org/userfiles/file/ars/2015/1/Saopstenje%20-%20ARS%20I%20KVARTAL%202015%20konacno.pdf>

mirave dhe produkteve, shërbimet, të ardhurat nga qiraja) dhe vetëm 5% nga burime të tjera. CRNVO ka kërkuar një ri-shikim të të dhënave për aktivitetin ekonomik, pasi Administrata Tatimore raportoi mbi një OShC që ka fituar gjysmën e këtyre të ardhurave.

Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në Mal të Zi përbëjnë 0.58% të PBB-së⁶³ kombëtare për vitin 2014.

Të ardhurat mesatare për OShC ishin 6,027 euro, ose mesatarja e dytë më e ulët në vendet e mbuluara në këtë raport.

Shpenzimet e përgjithshme për tatime dhe përfitime ishin 2,412,9459 euro. Duke qenë se nuk ka të dhëna për shpenzimet e përgjithshme,⁶⁴ është e pamundur të bëhen interpretime dhe/ose korrelacione me indikatorët e tjerë.

Mbetet e paqartë pse disa të dhëna nuk janë të disponueshme, edhe pse ato janë pjesë e "paketës". Për shembull, nëse të dhënat mbi të ardhurat e përgjithshme janë të disponueshme, dhe ato për shpenzimet e përgjithshme duhet të jenë gjithaq, pasi këto të dhëna nxirren nga i njëjti raport financiar. Nëse shpenzimet për tatimet dhe përfitimet janë të disponueshme, është logjike që duhet të jenë të disponueshme dhe të dhënat për numrin e të punësuarve, duke qenë se këto të dhëna janë të lidhura drejtpërdrejt (tatimet dhe përfitimet mbliidhen për çdo punëmarrës).

Të dhënat për numrin e të punësuarve në sektorin e shoqërisë civile janë të përkohshme. Administrata Tatimore ka raportuar 776 të punësuar në shtator 2015. Llogaritja bazohet në titujt e të punësuarve (i.e. ata që kanë tog-fjalëshin 'jo-qeveritare' në emrat e tyre). Duke pasur parasysh se vendosja e tog-fjalëshit "jo-qeveritare" në titullin e organizatës nuk është e detyrueshme, mund të vlerësohet se ka më shumë njerëz të punësuar në sektorin e OShC-ve sesa raportohet nga Administrata Tatimore.

Të punësuarit në sektorin jofitimprurës përfaqësojnë 0.37% të punësimit të përgjithshëm në Mal të Zi.

Nuk mbliidhen të dhëna mbi vullnetarizmin.

⁶³ <http://countryeconomy.com/gdp/montenegro>

⁶⁴ Nuk u sigurua informacion zyrtar para publikimit të këtij raporti.

Rekomandime për Malin e Zi

- Kërkimi i burimeve të tjera të mundshme për të dhënat statistikore në lidhje me sektorin jofitimprurës me përjashtim të tre institucioneve të identifikuara tashmë;
- Shfrytëzimi i mekanizmave ekzistues për të ndikuar në procesin e mbledhjes së të dhënave, analizimin dhe publikimin e tyre (personi i kontaktit për OJQ-të, Këshilli Statistikor);
- Shqyrtimi i mundësive për të kryer dallimin e sektorit të shoqërisë civile nga sektorët e tjerë duke përdorur klasifikime, numrat e TVSH-së, ose dhe numrat identifikues. Advokimi për botimin e rregullt të të dhënave ekonomike bazë mbi sektorin jofitimprurës, duke qenë se këto statistika tashmë mblidhen nga organet përkatëse (të ardhurat e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, shpenzimet e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, të dhëna të disagreguara për punësimin në sektor: numri i përgjithshëm i të punësuarve total dhe sipas llojit të kontratës, paga mesatare, etj.);
- Ofrimi i të dhënave pa pagesë, në një dokument publik të aksesueshëm në faqen e internetit të institucioneve përkatëse; Grumbullimi i të dhënave në një dokument unik do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt paraqitjes së të dhënave ekonomike për sektorin;
- Përdorimi i dokumentave strategjikë që njohin rëndësinë dhe nevojën për mbledhjen sistematike të të dhënave, botimin dhe analizën e tyre si një mjet advokacie për disponueshmërinë e të dhënave (p.sh. Strategjia për zhvillimin e organizatave jo-qeveritare në Malin e Zi 2014-2016, Plani i veprimit për Kapitullin 23 të Acquis të BE-së.).
- Mbledhja në mënyrë sistematike e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe zhvillimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB.

Serbia

Gjendja e mbledhjes së statistikave

Gjendja e mbledhjes së të dhënave rreth sektorit jofitimprurës në Serbi është sfiduese. Ky konstatim u konfirmua dhe gjatë përgatitjes së Draft Planit për Monitorimin dhe Vlerësimin (M&V) e Strategjisë Kombëtare për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e OShC-ve, 2016-2020.⁶⁵ Draft Plani është përgatitur si një pjesë integrale e Strategjisë me qëllim krijimin e një sistemi të monitorimit dhe vlerësimit. Për të mbledhur të dhënat e disponueshme mbi sektorin jofitimprurës u krye një studim bazë. Që në krye të herës, u bë e qartë se në ndryshim nga sektorët e tjerë, ku burimi kryesor i të dhënave është Zyra Statistikore e Republikës së Serbisë (SORS), veprimtaria e OShC-ve nuk mbulohet nga një anketë e vetme e SORS-it. Të dhënat për OShC-të kryesisht mblidhen nga Agjencia Serbe e Regjistrimit të Bizneseve (SBRA). Të dhënat e tjera janë të shpërndara midis institucioneve të ndryshme ose mblidhen nga anketat sporadike të disa institucioneve dhe/ose OShC-ve.

Kjo situatë shpjegohet pjesërisht prej faktit se SBRA është e ligjërish detyruar të regjistrojë OShC-të dhe raportet e tyre financiare, duke mbledhur kështu të dhënat bazë për madhësinë dhe fushëveprimin e sektorit. Përveç kësaj, sektori jofitimprurës në Serbi është relativisht i ri – ku 50% e OShC-ve janë regjistruar prej 2010 – duke mbuluar një gamë të larmishme tematike, me një sërë aktivitetesh të cilat nuk janë as të klasifikuara dhe as të standardizuara, duke e bërë mbledhjen e të dhënave akoma më sfiduese.

Në të njëjtën kohë, përgatitja e studimit bazë tregoi se edhe pse disa të dhëna nuk përpunohen dhe shpërndahen për publikun, ato mblidhen në mënyrë të rregullt. Për shembull, Fondi Pensional i Serbisë mbledh informacione për të punësuarit në OShC (pavarësisht llojit të kontratës), sigurimet e tyre shoqërore dhe vitet e angazhimit në OShC. Nga ana tjetër, mungojnë disa të dhëna me rëndësi për sektorin (për shembull, të dhënat mbi vullnetarizmin dhe arsimin jo-formal).

Procesi i sipër-përmendur i hartimit të planit të M&V ishte një përpjekje që mundësoi vlerësimin e situatës së mbledhjes së të dhënave në lidhje me OShC-të, duke krijuar një pikë fillestare për të ardhmen e mbledhjes sistematike të të dhënave dhe analizimin e sektorit jofitimprurës në Serbi. Kjo do të kërkojë modifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit ekzistues të mbledhjes së të dhënave, qoftë përmes institucioneve të ndryshme, përmes anketave të rregullta vjetore ose përmes angazhimit të OShC-ve individuale.

⁶⁵ Draft Strategjia pritet të miratohet nga qeveria në fund të 2015.

Në aspektin e disponueshmërisë së statistikave, të dhënat kryesore përmbledhëse për OShC-të janë në dispozicion për publikun në faqen e internetit të SBRA-s, e cila nxjerr një Raport vjetor mbi punën e institucioneve jofitimprurëse.⁶⁶ Ky raport ka të dhëna mbi të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve, megjithatë ato nuk janë të strukturuar në një mënyrë të atillë që përshtatet me natyrën e financave të OShC-ve. Nëse kërkohen të dhëna specifike dhe më të detajuara, SBRA mund t'i mundësojë përkundrejt pagesës. Nëse institucionet shtetërore i kërkojnë të dhënat, ato vihen në dispozicion pa pagesë.

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Serbi

Popullsia (censusi i popullsisë 2011) ⁶⁷	7,186,862		
Numri i OShC-ve (shoqata: 22838, fondacione: 556) ⁶⁸	23,394		
Numri i qytetarëve për OShC	307		
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Serbi (2013)		
	Total	Shoqata	Fondacione
PBB ⁶⁹	34,263,000,000		
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	0.74%		
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	254,713,543	222,195,480	32,518,063
Të ardhura operative	244,199,250	213,209,747	30,989,503
Të ardhura financiare	5,096,108	4,117,888	978,220
Të ardhura të tjera	5,349,145	4,801,178	547,967
Fitimet neto të bizneseve	69,040	66,667	2,373
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve	247,615,305	215,451,510	32,163,796
Shpenzime operative	227,093,089	199,289,206	27,803,883
Shpenzime financiare	2,836,640	2,319,825	516,815
Shpenzime të tjera	17,232,574	13,389,921	3,842,653
Humbjet neto të bizneseve	453,002	452,557	445
Shpenzime për të punësuarit dhe personat e kontraktuar për sigurime shoqërore	8,580,129	7,740,666	839,463
Shpenzime për tatime	689,572	601,475	88,098
Numri i të punësuarve në OShC	6,729	6,170	559
Numri i përgjithshëm i të punësuarve ⁷⁰	1,715,164		
Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%)	0.39%	0.36%	0.03%

⁶⁶ http://www.apr.gov.rs/LinkClick.aspx?fileticket=cTuqyulHs_4%3d&tabid=286&portalid=0&mid=1717

⁶⁷ <http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/userFiles/file/Aktuelnosti/StatGod2015.pdf>

⁶⁸ <http://www.apr.gov.rs/>

⁶⁹ <http://countryeconomy.com/gdp/serbia>

⁷⁰ Mesatarja vjetore në 2013


<http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/Public/ReportResultView.aspx?rptKey=indId%3d240201IND01%2635%3d6%262%3d%23last%23%2633%3d0%2c1%2c2%2623%3d0%2c2%26sAreaId%3d240201%26dTy pe%3dName%26lTy pe%3dSer>

Numri i vullnetarëve	N/A	N/A	N/A
Paga mesatare në OShC (bruto)	591	454	728

1 EUR = 114.6 RSD

Sipas SBRA-s⁷¹ ka 26,731 OShC në Serbi, nga të cilat 26,076 janë shoqata dhe 655 fondacione dhe endowments (ose dhurimet e kushtëzuara). Të dhënat financiare në këtë raport mbulojnë vitin 2013, pasi të dhënat për vitin 2014 nuk janë ende të disponueshme. Në vitin 2013, kishte 23,394 OShC në Serbi, nga të cilat 22,838 ishin shoqata (97.6%) dhe 556 fondacione dhe endowments (2.4%).

Fondacionet/endowments dhe shoqatat janë subjekt i ligjeve dhe rregullimeve të veçanta, edhe pse SBRA është përgjegjëse për regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave të tyre financiare. Ndërsa shoqatave dhe fondacioneve nuk u nevojitet një kapital minimal për t'u ngritur ligjrisht, vlera minimale e kapitalit themeltar për një endowment është 30,000 euro dhe ka dhe një kërkesë ligjore për ruajtjen e vlerës së këtij kapitali.



Nga të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve për vitin 2013, të ardhurat e shoqatave përfaqësojnë 87% të totalit, ndërsa të ardhurat e fondacioneve dhe edowments vetëm 13%. Kjo vjen si rrjedhojë e numrit shumë të vogël të fondacioneve/endowments në Serbi, ku në pesë vitet e fundit janë ngritur 40% e tyre.

⁷¹ <http://www.apr.gov.rs/eng/Home.aspx>

Struktura e të ardhurave të OShC-ve, 2013



Sipas SBRA-s, 76% e numrit të përgjithshëm të OShC-ve dorëzuan raportet e tyre financiare për vitin 2013. Të ardhurat e tyre të përgjithshme ishin 254,713,543 euro, nga të cilat 96% ishin të ardhura operative, ndërsa pjesa tjetër ndahej në mënyrë të barabartë midis të ardhurave financiare dhe të ardhurave të tjera. Struktura e të ardhurave të shoqatave dhe fondacioneve/endowments paraqitet e ngjashme, edhe pse mungon niveli i detajimit që reflekton tiparet dalluese të OShC-ve.

Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në Serbi përfaqësojnë 0.74% të PBB-së kombëtare për vitin 2013.

Të ardhurat mesatare për OShC ishin 10,888 euro. Është me rëndësi të theksohet ndryshimi i mesatares midis shoqatave (9,781 euro) dhe fondacioneve (58,486 euro). Nëse mesatarja llogaritet në bazë të numrit të OShC-ve që kanë dorëzuar raportet e tyre financiare, atëherë mesataret paraqiten pak më të larta: 14,353 euro për OShC-të e agreguara, 12,841 euro për shoqatat dhe 73,570 euro për endowments.


Siç u përmend më lart, në raportin përmbledhës të SBRA-s, struktura e të ardhurave nuk pasqyron në detaje karakteristikat e sektorit jofitimprurës. Për shembull, nuk është e dukshme se cilën pjesë përfaqësojnë grantet dhe donacionet dhe cilën pjesë kuotat e anëtarësimi.

Struktura e shpenzimeve të OShC-ve, 2013



Për vitin 2013, shpenzimet e përgjithshme të sektorit të shoqërisë civile në Serbi ishin 247,615,305 euro, nga ku shpenzimet operative zinin 92% të këtij totali. Shpenzimet financiare përfaqësonin 1% të totalit, ndërsa shpenzimet e tjera rreth 7%. Shpenzimet mesatare për OShC ishin 9,508 euro. Shpenzimet për të punësuarit ishin 8,580,129 euro, ose 3.5% e shpenzimeve të përgjithshme të OShC-ve. Struktura e shpenzimeve në raportin e SRBA nuk është e detajuar.

Të punësuarit në OShC, 2013



Të dhënat nga SBRA tregojnë se në Serbi numri mesatar i të punësuarve në OShC në 2013 ishte 6,729, nga ku 92% ishin të punësuar në shoqata dhe vetëm 8% në fondacione/endowments. Ky numër përfaqëson 0.39% të numrit të përgjithshëm të punësuarve në Serbi për 2013. Ndërkohë, mesatarja e të punësuarve në OShC ishte

0.29, nga ku mesatarja e shoqatave ishte 0.27 ndërsa e fondacioneve/endowments 1.01.

Numri i personave të angazhuar në OShC me lloje të ndryshme kontratash është më i madh, çka e dyfishon numrin e punësimit aktual në sektorin e shoqërisë civile. Kjo konfirmohet nga të dhënat e Fondit Pensional që tregojnë se në vitin 2013, kishte 14,206 persona të punësuar përmes llojeve të ndryshme të kontratave në OShC-të në Serbi, që zinin 0.83% të punësimit të përgjithshëm në atë vit.

Në lidhje me vullnetarizmin, nuk ka të dhëna sistematike e gjithëpërfshirëse për numrin e vullnetarëve, orët e punës vullnetare ose vlerën e tyre monetare. Mblidhen disa të dhëna nga Ministria e Punës, Punësimit dhe Çështjeve Sociale siç përcaktohet në Ligjin për Vullnetarizmin (ministria regjistron organizatorët e punës vullnetare, vullnetarët, merr raporte nga organizatorët etj). Megjithatë, këto statistika nuk janë të besueshme pasi pjesa më e madhe e OShC-ve nuk i dorëzojnë raportet/informacionet e kërkuara. Për shembull, të dhënat e Ministrisë tregojnë se në vitin 2014 kishte 1,166 vullnetarë të regjistruar, ndërsa një studim i vitit 2011⁷² tregoi se ka më shumë se 150,000 vullnetarë aktivë në Serbi.

Rekomandime për Serbinë

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e OShC-ve 2016-2020 dhe i Planit të Monitorimit dhe Vlerësimit që priten të miratohen së shpejti. OShC-të duhet të insistojnë për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe publikimin e tyre siç parashikohet në këto dokumente. Kjo kërkon zhvillimin e disa fushatave advokuese në lidhje me kapituj të ndryshëm të mbuluar nga Strategjia;
- Sigurimi i të dhënave transparente dhe të detajuara mbi performancën financiare të sektorit jofitimprurës dhe publikimi i tyre në mënyrë më të detajuar se ai aktual (struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve të detajuara për shoqatat dhe fondacionet/endowments);
- Mbledhja në mënyrë sistematike e të dhënave mbi vullnetarizmin, si dhe zhvillimi i një metodologjie për të llogaritur vlerën monetare të punës vullnetare dhe kontributin e saj në PBB.

⁷² Vlerësim i Situatës në Sektorin e OShC-ve, shtator 2011; Civic Initiatives në bashkëpunim me Zyrën për Bashkëpunimin me Shoqërinë Civile.

Turqia

Situata e mbledhjes së statistikave

Sipas Matricës së Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Raporti për Turqinë 2014,⁷³ fondacionet dhe shoqatat janë subjekt i ligjeve dhe të veçanta dhe rregullohen nga agjenci publike të ndryshme. Departamenti i Shoqatave (DoA) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Fondacioneve (GDoF), përveç rolit udhëzues dhe detyrave të tyre administrative, janë autoritetet përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave mbi OShC-të. Megjithatë, pavarësisht disa përpjekjeve të kohëve të fundit për të bërë të disponueshme për publikun disa statistika të përgjigjithshme për shoqatat dhe fondacionet, statistikave të OShC-ve nuk janë integruara në programin e statistikave zyrtare të Institutit të Statistikave të Turqisë. Shoqatat dhe fondacionet janë të detyruara me ligj të paraqesin statistika të përditësuara në njoftimet e tyre vjetore për DoA dhe GDoF, por sasia dhe cilësia e informacionit të ndarë për publikun nga këto autoritete nuk është e mjaftueshme.

Në kuadër të procesit të zbatimit të e-qeverisë në Turqi, DoA filloi mbledhjen e të dhënave mbi jofitimprurëset përmes DERBIS ose Sistemit të Informacionit të Shoqatave, që u bë operativ në 18 shkurt 2013. Qysh atëherë, më shumë se gjysma e shoqatave kanë dorëzuar profilet dhe raportet e tyre vjetore online në bazën e të dhënave të sistemit. Më parë, këto të dhëna nuk ndaheshin me publikun. Çdo vit DoA dhe GDoF mbledh statistika mbi vullnetarët. Ndërsa GDoF i bënte publike të dhënat, DoA nuk i ndante këto statistika. Që prej 2014, DoA ka mundësuar disponueshmërinë e të dhënave të tjera të mëtejshme mbi shoqatat që të cilat ishin të aksesueshme më parë.

Në praktikë, duket se ka një mbivendosje në sigurimin e të dhënave për organet e ndryshme shtetërore çka mund të vendos një barrë shtesë për OShC-të. Për shembull, të gjitha shoqatat dhe fondacionet duhet të dorëzojnë dokumentacionet përkatëse në lidhje me të dhënat mbi strukturën e të ardhurave/shpenzimeve tek autoriteti tatimor, përveç të dhënave që mblidhen nga DoA dhe GDoF. Në mënyrë të ngjashme, të dhënat për të punësuarit mblidhen çdo vit nga DoA dhe GDoF, si dhe nga Ministria e Punës dhe Sigurisë Sociale që ka të gjitha të dhënat për stafin e punësuar.

Një pjesë e të dhënave të paraqitura në këtë raport nuk është ende publike, prandaj këto të dhëna duhet të konsiderohen si paraprake. TUSEV mundësoi mbledhjen e këtyre të dhënave përmes grupit të punës të BE-së të ngritur në 2013 për të punuar

⁷³ <http://monitoringmatrix.net/monitoring-matrix/civil-society-and-civil-society-development-in-turkey-2014/>

mbi Udhëzimet e BE-së. Këto të dhëna përfshijnë numrin e vullnetarëve, numrin e të punësuarve me kohë të plotë në shoqata, burimet e të ardhurave të shoqatave dhe numrin e sanksioneve të vëna mbi shoqatat. Përveç kësaj, formati i informacionit të dhënë nga institucionet publike nuk është i standardizuar. Për shembull, GDoF i përpilon të gjitha të dhënat statistikore në lidhje me fondacionet në një dokument të vetëm PDF që është i vështirë të përdoret për qëllime kërkimore.

Ligji aktual për të drejtën e informimit (Nr. 4982, 9/10/2003) parashikon disa kufizime të së drejtës për informim nëse informacioni i kërkuar (1) kërkon punë dhe hulumtime shtesë, (2) konsiderohet "sekret shtetëror", (3) sfidon "sigurinë kombëtare" ose "përfitimet ekonomike të vendit" (4) ka të bëjë me veprimtarinë e brendshme të institucionit publik dhe nuk ka dimension të interesit publik. Termat si "sekret shtetëror", "siguri kombëtare" apo "përfitime ekonomike të vendit" nuk janë të përkufizuara në kuadrin ligjor duke u lënë institucioneve publike autoritet interpretues dhe pushtet diskrecional. Për shembull, në vitin 2014 TUSEV dërgoi 20 kërkesa të veçanta për informacion publik mbi marrëdhëniet e ministrive me OShC-të tek ministritë përkatëse. 16 Ministri iu përgjigjën kërkesave dhe 4 prej tyre refuzuan të japin informacion me arsyetimin se nevojiten përpjekje/hulumtime shtesë për sigurimin e tyre (duke ushtruar të drejtat e tyre sipas neneve 7 dhe 12 të Ligjit Për të drejtën e informimit). Ministritë përdorin aplikacione të ndryshme interneti për të trajtuar kërkesat për të drejtën për informim dhe ndërsa disa prej sistemeve të aplikimit online janë miqësore për përdoruesit, disa janë inefiçente.⁷⁴

Statistika ekonomike kyçe mbi sektorin jofitimprurës në Turqi

Popullsia (2013)	76,667,864		
Numri i OShC-ve në 2013 (97,970 shoqata, 4,757 fondacione) ⁷⁵	102,727		
Numri i qytetarëve për OShC	746		
Të dhëna mbi performancën ekonomike	Turqi (2013)		
	Total	Shoqata	Fondacione
PBB ⁷⁶	616,345,000,000		
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve në raport me PBB (%)	1.34%		
Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve	8,282,157,668	3,042,800,238	5,239,357,430
Struktura e të ardhurave			
Donacione të huaja	99,937,971	53,351,626	46,586,345

⁷⁴ http://www.tacso.org/doc/tr_rim_report.pdf

⁷⁵ Burimi: Departamenti i shoqatave dhe Drejtoria e Fondacioneve

⁷⁶ <http://countryeconomy.com/gdp/turkey>

Kuotat e anëtarësisë	1,242,954,528	281,107,138	961,847,390
Fonde publike	700,129,748	148,322,519	551,807,229
Donacione	2,852,556,908	1,265,006,707	1,587,550,201
Të ardhura nga aktiviteti ekonomik	143,919,981	79,662,953	64,257,028
Të ardhura financiare	994,752,282	175,475,173	819,277,108
Të ardhura të tjera	2,178,486,458	970,454,329	1,208,032,129
Të ardhura nga qeraja	69,419,792	69,419,792	
Shpenzimet e përgjithshme të OShC-ve	4,916,022,161	2,561,770,347	2,354,251,814
Struktura e shpenzimeve			
Shpenzimet	966,564,472	713,537,088	253,027,385
Shpenzimet për të punësuarit	761,830,594	448,959,578	312,871,016
Shpenzimet për të përmbushur qëllimin e fondacioneve	2,873,008,082	1,084,654,669	1,788,353,414
Shpenzime të tjera	314,619,012	314,619,012	
Shpenzime për tatimet (TVSH+tatimi mbi të ardhurat personale+tatimi mbi fitimin)		N/A	
Numri i të punësuarve në OShC	50,976	33,783	17,193
Numri i përgjithshëm i të punësuarve	25,933,000 ⁷⁷		
Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%)	0.29%	0.13%	0.07%
Numri i vullnetarëve	1,183,435	75,608	1,107,827 ⁷⁸
		1 EUR = 2.87 TL	

Në vitin 2013, numri i përgjithshëm i OShC-ve në Turqi ishte 102,727, nga ku 97,970 ishin shoqata (95%) dhe 4,757 ishin fondacione (5%).

Ka disa ndryshime në ligjet për fondacionet dhe shoqatat, ku strukturat e të ardhurave përcaktohen ndryshe. Si rrjedhojë, të dhënat në këtë raport janë paraqitur të ndara sipas llojit të organizatës.

Fondacionet dhe shoqatat janë subjekt i ligjeve dhe të veçanta dhe rregullohen nga agjenci publike të ndryshme. Në ndryshim nga shoqatat, për ngritjen e një fondacioni nevojitet një minimum kapitali themeltar.

Asetet (të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, duke përfshirë likuiditetet, letrat me vlerë dhe obligacionet) duhet të alokohen për qëllimin e specifikuar të fondacionit. GDoF përcakton vlerën minimale të kapitalit themeltar për krijimin e një fondacioni dhe aktualisht kjo vlerë është 20,000 euro. Për të fituar statusin e përfitimit

⁷⁷ <http://www.turkstat.gov.tr/UstMenu.do?metod=temelist>


⁷⁸ <http://www.turkstat.gov.tr/UstMenu.do?metod=temelist>

publik, kjo vlerë shkon në rreth 300,000 euro. Fondacionet nuk janë të detyruara ta ruajnë kapitalin themeltar, por as nuk inkurajohen ta shpenzojnë atë.⁷⁹



Nga të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve për vitin 2013, 63% e të ardhurave vjen nga fondacionet dhe 37% nga shoqatat. Siç u përmend më lart, për shkak të kapitalit themeltar të kërkuar për të ngritur një fondacion, të ardhurat e përgjithshme të fondacioneve janë shumë më të mëdha se të ardhurat e shoqatave, edhe pse numri i shoqatave e tejkalon numrin e fondacioneve.

Struktura e të ardhurave të OShC-ve, 2013 (%)



Struktura e përgjithshme e të ardhurave tregon se pak më shumë se një e treta (34%) e të ardhurave vjen nga donacionet, ndjekur nga të ardhurat e tjera⁸⁰ (26%), kuotat e

⁷⁹ Raporti EFC:

http://www.tusev.org.tr/usrfiles/files/Comparative_Highlights_of_Foundation_Laws.pdf


⁸⁰ Nuk ka informacion se çfarë përfshijnë "të ardhurat e tjera".

anëtarësimit (15%), të ardhurat financiare (12%) dhe fondet publike (8%). Shumë pak të ardhura vijnë nga aktiviteti ekonomik (2%), donacionet e huaja (1%) dhe qeraja (1%).

Dallimet në strukturën e të ardhurave mes fondacioneve dhe shoqatave janë mjaft të dukshme. Pjesa më e madhe e të ardhurave të shoqatave vjen nga donacionet (42% donacione të brendshme dhe 2% donacione të huaja). Ndërkohë, edhe pse pjesa më e madhe e të ardhurave të fondacioneve vjen nga donacionet (donacionet e brendshme 30% dhe 1% donacionet e huaja), ato zënë më pak se një të tretën e të ardhurave të përgjithshme. Për shoqatat një e treta e të ardhurave vjen nga “të ardhurat e tjera” (32%), ndërsa ato zënë 23% të të ardhurave të fondacioneve. Ndërkaq, 18% e të ardhurave të fondacioneve vjen nga tarifatat e anëtarësisë, por ky zë përfaqëson vetëm 9% të të ardhurave të shoqatave.

Të ardhurat mesatare të shoqatave janë 31,058 euro, ndërsa të ardhurat mesatare të fondacioneve janë 1,101,400 euro.


Të ardhurat e përgjithshme të OShC-ve përfaqësojnë 1.34% të PBB-së⁸¹ kombëtare për vitin 2013, që është dhe përqindja më e lartë në mesin e vendeve të mbuluara në këtë raport.



Fondacionet përbëjnë 48% të shpenzimeve të përgjithshme, ndërsa shoqatat 52%. Në vitin 2013, shoqatat shpenzuan 84% të të ardhurave të tyre të përgjithshme, ndërsa fondacionet 45%. Kjo ndoshta vjen si rrjedhojë e faktit se është i nevojshëm një kapital minimal për ngritjen e një fondacioni. Fondacionet nuk janë të detyruara ta ruajnë kapitalin themeltar, por as nuk inkurajohen ta shpenzojnë atë.

⁸¹ <http://countryeconomy.com/gdp/turkey>

Struktura e shpenzimeve të OShC-ve, 2013



Në nivelin e shpenzimeve të përgjithshme të OShC-ve, pjesa më e madhe (58%) shkon për përmbushjen e qëllimit të organizatës. Një e pesta (20%) përfaqëson zërin e “Shpenzimeve”,⁸² ndjekur nga shpenzimet për të punësuarit (15%) dhe për shpenzimet e tjera (6%). Përsëri, ka një dallim të dukshëm mes fondacioneve dhe shoqatave në strukturën e shpenzimeve. Më shumë se tre e katërta (76%) e shpenzimeve të fondacioneve shkon për përmbushjen e qëllimit të tyre; 13% shkon për shpenzimet për të punësuarit, ndërsa 11% shkon për zërin “Shpenzime”. Në të njëjtën kohë, edhe pse është më pak se gjysma e shpenzimeve të përgjithshme (42%) pjesa më e madhe e shpenzimeve të shoqatave shkojnë për përmbushjen e qëllimit, ndjekur nga zëri “Shpenzime” (28%), shpenzimet për të punësuarit (18%) dhe “shpenzimet e tjera” (12%). Kur këto të dhëna komplementohen me informacionin mbi numrin mesatar të të punësuarve (shih të dhënat në grafikun e mëposhtëm), problemi i mungesës së burimeve njerëzore në shoqata del në pah.


⁸² Nuk ka informacion se çfarë përfshijnë “shpenzimet”.

Të punësuarit në OShC, 2013



Përkundër faktit se të ardhurat e përgjithshme dhe shpenzimet mesatare për të punësuarit janë më të larta për fondacionet, numri i përgjithshëm i të punësuarve është dy herë më i madh për shoqatat. Dy të tretat e të punësuarve (66%) punojnë në shoqata dhe një e treta në fondacione (34%). Megjithatë, duke qenë se ka një ndryshim të rëndësishëm në numrin e shoqatave dhe fondacioneve, vlen të theksohet se numri mesatar i të punësuarve në shoqatë është 0.34, ndërsa numri mesatar i të punësuarve në fondacion është 3.61.

Të punësuarit në OShC në raport me punësimin e përgjithshëm (%), 2013



Raporti i punësimit në OShC është vetëm 0.20% ose shifra më e ulët në mesin e vendeve të mbuluara, edhe pse përqindja e të ardhurave të përgjithshme të OShC-ve në PBB-në kombëtare është më e larta në krahasim me vendet e tjera. Të punësuarit në shoqata përbëjnë 0.13% të punësimit të përgjithshëm në Turqi në vitin 2013, ndërsa ata që punojnë në fondacione 0.07%.

Turqia është vendi i vetëm (në mesin e atyre që mbulohen nga ky raport) që mbledh të dhëna në mënyrë më sistematike mbi vullnetarët. Nga numri i përgjithshëm i vullnetarëve, 94% janë të angazhuar në fondacione dhe vetëm 6% në shoqata. Megjithatë, siç u shpjegua më lart, këto të dhëna nuk janë plotësisht të besueshme pasi

nuk ka asnjë përkufizim zyrtar të vullnetarizmit, dhe disa fondacione, për shembull, i deklarojnë financuesit e tyre si vullnetarë.

Rekomandime për Turqinë

- Nevoja për një përfshirje më të madhe të statistikave të OShC-ve në programin zyrtar statistikor të mbajtur nga Instituti i Statistikave të Turqisë. Kjo përfshin edhe të dhënat e ofruara nga DoA dhe GDoF, të cilat duhet të përfshihen në sistemin e statistikave kombëtare, duke rritur kështu sasinë dhe cilësinë e të dhënave mbi OShC-të në dispozicion të publikut dhe duke shmangur mbivendosjen;
- Përgatitja e manualeve nga ana e institucionet publike për të orientuar OShC-të në procesin e raportimit, për të marrë të dhëna me cilësi të lartë nga OShC-të;
- Publikimi i rregullt i të dhënave ekonomike bazë për sektorin jofitimprurës, duke qenë se këto të dhëna mbliidhen tashmë nga organet përkatëse (të ardhurat e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, shpenzimet e përgjithshme dhe struktura e tyre e detajuar, të dhëna të disagreguara për punësimin në sektor: numri i përgjithshëm i të punësuarve total dhe sipas llojit të kontratës, paga mesatare, etj.);
- Përgatitja e standardeve të veçanta të kontabilitetit për OShC-të;
- Ofrimi i të dhënave në një format lehtësisht të aksesueshëm dhe të lexueshëm (të dhënat e siguruar nga institucionet publike janë kryesisht në format PDF që nuk është lehtësisht i përdorshëm për qëllime studimore);
- Zbatimi më i mirë i ligjit për të drejtën e informimit, duke përfshirë edhe miratimin e masave specifike për agjencitë qeveritare dhe aplikacionet standarde në internet për të lehtësuar procesin e kërkesave për informim. Rekomandimet specifike të hartuara nga takimi i fokus grupit Mbi Praktikën që lidhen me të Drejtën e Informimit (mbajtur në janar të vitit 2014) duhet të ndiqen më tej;
- Standardizimi i faqeve të internetit të institucioneve publike përkatëse për të siguruar një informacion të plotë dhe të përditësuar;
- Krijimi i një përkufizimi të vullnetarizmit, i cili do të eliminojë konfuzionin në mbledhjen sistematike të të dhënave. Nevojitet hartimi i një metodologjie për llogaritjen e vlerës monetare të punës vullnetare dhe kontributit të saj në PBB.

Shtojcat

Shtojca 1. Të dhëna statistikore – Vlera ekonomike e sektorit jofitimprurës – Drafti i parë

Vendi: _____

N r.	Të dhënat mbi performancën ekonomike	Të disponueshme (Po/Jo)	Nëse PO kush i mbledh statistikat ⁸³	Nëse PO ,statistikat janë të disponueshme		Koha e publikimit
				publikisht	me kërkesë	
1	Të ardhurat e përgjithshme					
2	Kontributi në PBB					
3	Struktura e të ardhurave					
4	Shtrirja e OShC-ve sipas të ardhurave					
5	Top 10 sipas të ardhurave					
6	Shpenzimet e përgjithshme					
7	Struktura e shpenzimeve					
8	Shpenzimet për të punësuarit					
9	Shpenzimet për honorare					
10	Shpenzimet për TVSH					
11	Shpenzimet për tatime					
12	Numri i të punësuarve					
13	Top 10 sipas numrit të punësuarve					
14	Pjesëmarrja në punësimin e përgjithshëm ⁸⁴					
15	Paga mesatare (neto/bruto)					
16	Numri i vullnetarëve					
17	Numri i orëve të vullnetarëve					
18	Vlera e punës vullnetare					
19	Aktiviteti ekonomik i regjistruar					

Shtojca 2. Të dhëna statistikore – Vlera ekonomike e sektorit jofitimprurës – versioni përfundimtar

Nr.	Të dhëna mbi performancën ekonomike	Emri i vendit (viti i statistikave të paraqitura)
1	Të ardhurat e përgjithshme	
2	Struktura e të ardhurave	
3	Shpenzimet e përgjithshme	
4	Struktura e shpenzimeve	
5	Shpenzimet për tatimet (TVSH+tatimi mbi të ardhurat personale+tatimi mbi fitimin)	
6	Numri i të punësuarve	
7	Numri i vullnetarëve	

⁸³ P.sh. zyrat statistikore, gjykata, ministri, zyrat e tatimeve etj.

⁸⁴ Mund të kombinohet me punën e papaguar (vlera e vullnetarizmit).



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky studim është prodhuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe BTD. Përmbajtja e këtij studimi është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e BE-së ose BTD-së.



BALKAN
CIVIL
SOCIETY
DEVELOPMENT
NETWORK